- **Rruga e Emërtimit Elektronik:** Prekni Cilësime/Rregulla dhe Siguri ose futni *#07#, ju mund të gjeni më shumë informacion rreth emërtimit (1).

Në faqen tonë të internetit, ju do të gjeni sektorin tonë FAQ (Pyetjet e Kërkuara më Shpesh). Ju gjithashtu mund të na kontaktoni me postë elektronike për të pyetur për çdo pyetje që mund të keni.

Një version elektronik i këtij udhëzuesi përdorimi është i mundur në Anglisht dhe gjuhë të tjera sipas disponueshmërisë në serverin tonë:

**www.alcatel-mobile.com**

**4034X/4034D/4034F/5010X/5010D/5010U:**

Telefoni është pajisje marrëse-dhënëse në GSM në brezin e katërt (850/900/1800/1900 MHz), UMTS në dy breza frekuencash(900/2100).

**5045X/5045D:**

Telefoni është pajisje marrëse-dhënëse në GSM në brezin e katërt (850/900/1800/1900 MHz), UMTS në brezin e katërt (850/900/1900/2100 MHz), ose LTE në brezin e gjashtë (B1/3/7/8/20/28A).

CE 1588

Kjo pajisje është në përputhje me kërkesat thelbësore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 1999/5/EC. Kopja e plotë e Deklaratës të Konformitetit për telefonin tuaj mund të merret nga faqja jonë e Internetit: www.alcatel-mobile.com.

(1) varet nga shtetet.

## Mbrojtja ndaj vjedhjes [1]

Telefoni juaj identifikohet nga IMEI (numri i serisë së telefonit) që tregohet në etiketën e paketimit dhe në memorien e telefonit. Ne rekomandojmë që ta mbani shënim numrin herën e parë që përdorni telefonin, duke futur *#06# dhe ta ruani atë në vend të sigurt. Ky numër mund të kërkohet nga policia ose operatori nëse ju vjedhin telefonin. Ky numër bën të mundur që celulari të bllokohet, duke penguar përdorimin e tij nga një person tjetër, qoftë edhe me kartë tjetër SIM.

(1) Kontaktoni me operatorin e rrjetit tuaj për të kontrolluar disponueshmërinë e shërbimit.



## Deklarim për mos-mbajtje përgjegjësie

Midis përshkrimit në manualin e përdoruesit dhe në funksionimin e telefonit tuaj mund të ketë disa ndryshime, në varësi të versionit të softuerit të telefonit tuaj ose të shërbimeve të veçanta të operatorit.

TCL Communication nuk do të mbajë përgjegjësi për këto ndryshime, nëse ka, as për pasojat e mundshme të tyre, përgjegjësi e cila do të mbahet ekskluzivisht nga operatori. Ky receptor telefoni mund të përmbajë materiale, përfshirë aplikacione dhe programe të ekzekutueshëm ose në formën e kodit të burimit, që është paraqitur nga palë të treta për përfshirje në këtë receptor telefoni ("Materiale të Palës së Tretë"). Të gjithë materialet e palës së tretë në këtë receptor telefoni janë dhënë "njëlloj siç janë" pa garanci të çdo lloji, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar, duke përfshirë garancitë e nënkuptuara të shitjes, përshtatje për një qëllim të veçantë ose përdor/përdorimin e palës së tretë, ndërveprimit me materiale të tjera ose përdorimit të blerësit dhe mos shkeljes së të drejtave të autorit. Blerësi merr përsipër që TCL Communication ka përputhje me të gjithë detyrimet cilësore që ka për detyrë si prodhues i pajisjes celulare dhe receptorit telefonik në përputhje të drejtat e Pronësisë Intelektuale. TCL Communication nuk do të jetë përgjegjës në asnjë fazë për paaftësi ose dështim të funksionimit të Materialeve të Palës së Tretë në këtë receptor telefoni ose në ndërveprim me çdo pajisje tjetër të blerësit. Deri në masën maksimale të lejuar nga ligji, TCL Communication hedh poshtë të gjitha përgjegjësitë për çdo pretendim, kërkesë, përshtatje apo veprime dhe më konkretisht - por pa u kufizuar në - veprime të ligjit të gabuara, nën çdo teori të përgjegjësisë, që rrjedhin nga përdorimi, me çfarëdo mënyrë, apo përpjekje për t'u përdorur, të tilla Materiale të  Palëve të treta. Për më tepër, Materialet e Palës së Tretë aktuale, të cilat janë ofruar pa pagesë nga TCL Communication, mund të jenë subjekt përditësimi të paguar dhe përmirësimi në të ardhmen; TCL Communication nuk merr parasysh ndonjë përgjegjësi lidhur me kosto shtesë, e cila do të mbulohet ekskluzivisht nga blerësi. Disponueshmëria e aplikacioneve mund të ndryshojnë në varësi të vendeve dhe operatorëve ku aparati është përdorur; në asnjë rast lista e aplikacioneve të mundshme dhe programeve të siguruar me aparatet duhet të konsiderohet si një ndërmarrje nga TCL Communication; ajo do të mbetet thjesht si informacion për blerësit. Prandaj, TCL Communication nuk do të mbajë përgjegjës për mungesën e disponueshmërisë së një apo më shumë aplikimeve të dëshiruara nga blerësi, pasi disponueshmëria e saj varet nga vendi dhe operatori i blerësit. TCL Communication rezervon të drejtën në çdo kohë për të shtuar ose hequr Materiale të Palëve të Treta nga aparatet e saj pa njoftim paraprak; në asnjë rast TCL Communication do të mbahet përgjegjëse nga blerësi për pasoja që heqje e tillë mund të ketë për blerësit në lidhje me përdorimin ose përpjekje për të përdorur aplikacione të tilla dhe Materialet të Palëve të Treta.

# 1 Celulari ..........................................

## 1.1 Tastet dhe lidhjet

### 4034X/4034D/4034F:






### 5045X/5045D:



**5010X/5010D/5010U:**








**Tasti i pamjes së përgjithshme**

- Prek për të kaluar mes dokumenteve dhe aktiviteteve individuale të aplikacioneve.



**Tasti i ekranit kryesor**

- Nga cilido aplikacion ose ekran, prek për t'u kthyer në ekranin Kryesor.
- Shtyp gjatë për të aktivizuar Google Now.



**Tasti i kthimit pas**

- Prek për t'u kthyer pas në ekranin e mëparshëm ose për të mbyllur një dritare dialogu, menynë e opsioneve, panelin e njoftimeve etj.



**Tasti i ndezjes**

- Shtyp: Kyç ekranin/Ndez ekranin.
- Shtyp dhe mbaj shtypur: Shfaq menynë kërcyese për të zgjedhur nga **Rindiz, Fik,** dhe **Regjim fluturimi**.
- Shtyp dhe mbaj shtypur butonin e **Energjisë** për të paktën 10 sekonda për të rindezur me detyrim.
- Shtyp dhe mbaj shtypur tastin e **Energjisë** dhe tastin **Volumi lart** nën regjimin e fikjes për të hyrë në regjimin e rikuperimit.
- Shtyp dhe mbaj shtypur tastin e **Energjisë** dhe tastin e **Volumit poshtë** për të shkrepur një foto të ekranit.



**Tastet e volumit**

- Gjatë një thirrjeje, rregullon volumin e kufjeve ose të receptorit.
- Në modalitetin e muzikës/videove/transmetimit, rregullojnë volumin e pajisjes.
- Në modalitetin e përgjithshëm, rregullojnë volumin e ziles.
- Heshtin zilen e një thirrjeje hyrëse.

## 1.2 Fillimi

### 1.2.1 Konfigurimi

**Vendosja ose heqja e kartës SIM/microSD**

Kërkohet një kartë micro-SIM për të kryer thirrje dhe për të përdorur rrjetet celulare. Nëse ke një kartë SIM, fute përpara se të konfigurosh telefonin. Mos u përpiq të fusësh lloje të tjera SIM si kartat mini apo nano, pasi mund të dëmtosh telefonin.

Fike telefonin përpara se të vendosësh ose të heqësh kartën SIM/microSD.

**Karikimi i baterisë**

Këshillohet që të karikosh plotësisht baterinë. Statusi i karikimit tregohet nga një përqindje që shfaqet në ekran gjatë kohës që telefoni është i fikur. Përqindja rritet gjatë karikimit të telefonit.

Për të ulur konsumin dhe harxhimin e energjisë, shkëput karikuesin kur bateria është plotësisht e karikuar; çaktivizo Wi-Fi, GPS, Bluetooth ose aplikacionet që ekzekutohen në sfond kur nuk nevojiten. Te Cilësimet mund të ulësh nivelin e ndriçimit të ekranit dhe të shkurtosh kohën përpara se ekrani të kalojë në fjetje.

### 1.2.2 Ndezja e telefonit

Për të ndezur telefonin, mbaj shtypur tastin **Energjia** derisa telefoni të ndizet. Mund të kalojnë disa sekonda deri në ndezjen e ekranit. Shkyçe telefonin me rrëshqitje, kod PIN, fjalëkalim apo motiv përpara se të shfaqet ekrani Kryesor nëse ke vendosur një kyçje të ekranit te Cilësimet.

Nëse nuk di kodin PIN ose nëse e ke harruar atë, kontakto me operatorin e rrjetit. Mos e lër kodin PIN pranë telefonit. Ruaje këtë informacion në një vend të sigurt kur ai nuk është në përdorim.

### 1.2.3 Fikja e telefonit

Për të fikur telefonin, mbaj shtypur tastin **Energjia** derisa të shfaqen opsionet e Telefonit, më pas zgjidh **Fik**.



## 1.3 Ekrani kryesor

Prekja e tastit **Kryesor** gjithmonë të dërgon tek ekrani Kryesor dhe mund të personalizosh të gjitha ekranet Kryesore duke shtuar në to aplikacionet e preferuara, shkurtoret dhe miniaplikacionet. Në ekranin Kryesor seti i ikonave të vendosura poshtë është gjithmonë i dukshëm, në cilëndo prej faqeve Kryesore ku ndodhesh. Kjo gjithashtu përfshin butonin Aplikacion, i cili do të tregojë të gjitha aplikacionet e disponueshme.




**Shiriti i statusit**
- Treguesit e statusit/njoftimeve
- Prek dhe zvarrit poshtë për të hapur panelin e njoftimeve

Rrëshqit majtas ose djathtas për të parë panelet e tjera në ekranin kryesor

**Shiriti i Google Search**
- Prek ❶ për të hyrë te ekrani i kërkimit me tekst
- Prek ❷ për të hyrë te ekrani i kërkimit me zë

**Aplikacionet në panelin e të preferuarave**
- Prek për të hapur aplikacionin
- Shtyp gjatë për të zhvendosur ose hequr aplikacionet

**Skeda Aplikacioni**
- Preke për të hapur të gjitha aplikacionet

Ekrani Kryesor zgjerohet për të lejuar më shumë hapësirë për shtimin e aplikacioneve, shkurtoreve etj. Rrëshqit ekranin Kryesor horizontalisht majtas dhe djathtas për të parë pamjen e plotë të ekranit Kryesor. Pika e bardhë në pjesën e poshtme të ekranit tregon se cilin ekran po sheh.

### 1.3.1 Përdorim i ekranit me prekje

**Prek** 

Për të hapur një aplikacion, preke me gisht.

**Shtyp gjatë** 

Për të vendosur opsionet e disponueshme për një artikull, preke gjatë atë artikull. Për shembull: Zgjidh një kontakt te Kontaktet, shtype gjatë këtë kontakt, do të shfaqet një listë opsionesh.

**Zvarrit** 

Vendos gishtin mbi ekran për të tërhequr një objekt në një vendndodhje tjetër.

**Rrëshqit/Rrëshqit shpejt** 

Rrëshqit ekranin për të lëvizur lart e poshtë aplikacionet, imazhet, faqet e uebit. Mund ta rrëshqasësh ekranin edhe horizontalisht.

Pajisja mbështet gjithashtu zmadhimin me një gisht te funksionet e Mesazhet, Gmail, Kamera dhe Galeria. Prek dy herë ekranin për të zmadhuar/zvogëluar.

**Goditja e lehtë** 

E ngjashme me rrëshqitjen, por çokitja e bën të lëvizë më shpejt.

**Afro gishtat/Largo gishtat** 

Vendos dy gishta mbi sipërfaqen e ekranit dhe largoji ose bashkoji për të shkallëzuar një artikull në ekran.

**Rrotullo** 

Ndryshon automatikisht orientimin e ekranit nga vertikalisht në horizontalisht duke e kthyer telefonin anash për të pasur pamje më të mirë të ekranit.



### 1.3.2 Shiriti i statusit

Nga shiriti i statusit, mund të shohësh si statusin e telefonit (në të djathtë), ashtu edhe informacionin e njoftimeve (në të majtë).

**Paneli i njoftimeve**

Zvarrit poshtë shiritin e statusit për të hapur parë njoftimet dhe zvarrit poshtë përsëri për të hapur panelin e Cilësimeve të shpejta. Preke dhe zvarrite lart për ta mbyllur atë. Nga paneli i Njoftimeve, mund të hapësh artikuj dhe kujtues të tjerë të treguar nga ikonat e njoftimeve ose shfaq informacionin e shërbimit me valë.




Prek për të hapur panelin e cilësimeve të shpejta.

Prek një njoftim dhe rrëshqite atë anash për ta fshirë

Prek për të pastruar të gjitha njoftimet e bazuara në ngjarje (njoftimet e tjera në vazhdim do të mbeten).

**Paneli i cilësimeve të shpejta**

Prek dhe zvarrit Panelin e njoftimeve poshtë dy herë ose prek (ikona) për të hapur Panelin e cilësimeve të shpejta.




Fotoja e personalizuar do të tregojë nëse ke konfiguruar profilin në aplikacionin e Kontakteve (1)

Prek për të hapur **Cilësimet**

**Paneli i cilësimeve të shpejta**

- Prek ikonat për të aktivizuar/çaktivizuar funksionet ose për të ndryshuar regjimet
- Shtyp gjatë për të shfaqur cilësimet

### 1.3.3 Shiriti i kërkimit

Telefoni ofron një funksion kërkimi që mund të përdoret për të gjetur informacionin që dëshiron në telefon, në aplikacionet e tua ose në ueb.

(1) Shiko "3.3.1 Shfaqja e kontakteve"




### ❶ Kërko sipas tekstit

- Prek shiritin e kërkimit nga ekrani Kryesor
- Fut tekstin/ frazën për të cilën dëshiron të kërkosh.
- Prek në tastierë nëse dëshiron të kërkosh në ueb.

### ❷ Kërko me zë

- Prek nga shiriti i kërkimit për të shfaqur një ekran dialogues.
- Thuaj fjalën/ frazën për të cilën dëshiron të kërkosh. Një listë me rezultatet e kërkimit do të shfaqet nga e cila mund të zgjedhësh.

## 1.3.4 Bllokimi/zhbllokimi i ekranit

Për të mbrojtur telefonin dhe privatësinë, mund të kyçësh ekranin e telefonit me një shumëllojshmëri motivesh, PIN ose fjalëkalim, etj. nëpërmjet **Cilësimet > Cilësimet e kyçjes** (1) ose **Siguria** (2) **> Kyçja e ekranit**.

**Për të krijuar një motiv zhbllokimi të ekranit, PIN ose fjalëkalim** (Ndiq instruksionet në ekran)

- Shko te **Cilësimet > Cilësimet e kyçjes** (1) ose **Siguria** (2) **> Kyçja e ekranit > Motiv/PIN/Fjalëkalim**.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F) PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U).
(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).



- Konfiguro motivin tënd, kodin PIN ose fjalëkalimin.

**Për të kyçur ekranin e telefonit**

Shtyp butonin e **Energjisë** një herë për të kyçur ekranin.

**Për të shkyçur ekranin e telefonit**

Shtyp butonin e **Energjisë** një herë për të ndriçuar ekranin, rrëshqit për të vizatuar motivin e shkyçjes që ke krijuar ose fut kodin PIN ose fjalëkalimin për të shkyçur ekranin.

Nëse ke zgjedhur **Rrëshqitjen** si kyçje të ekranit, rrëshqite ikonën e kyçjes lart për të shkyçur ekranin, rrëshqit majtas për të hapur **Kamerën**, rrëshqit djathtas për të hapur **Telefoni** (1) ose për të hapur **Kërko me zë** (2).

## 1.3.5 Personalizimi i ekranit kryesor

**Shtimi i një aplikacioni ose miniaplikacioni**

Mund të shtypësh gjatë një dosje, një aplikacion ose një miniaplikacion për të aktivizuar regjimin Lëviz dhe zvarrite artikullin në ekranin Kryesor që preferon.

**Rivendosja e një aplikacioni ose widget**

Shtyp gjatë elementin që do të ripozicionosh për të aktivizuar regjimin "Lëviz", tërhiq artikullin në pozicionin e dëshiruar dhe pastaj lëshoje. Mund t'i zhvendosësh artikujt si në ekranin kryesor, ashtu edhe në panelin e të preferuarave. Mbaje ikonën në këndin e majtë ose të djathtë të ekranit për ta zhvendosur artikullin në një ekran tjetër kryesor.

**Heqja**

Shtyp gjatë elementin që do të hiqet për të aktivizuar regjimin "Lëviz", tërhiq artikullin deri mbi ikonën **Hiq** dhe lëshoje pasi artikulli të bëhet i kuq.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F).
(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D, 5010X, 5010D, 5010U).

**Krijimi i dosjeve**

Për të përmirësuar organizimin e artikujve (rrugëve të shkurtra ose aplikacioneve) në ekranin Kryesor dhe në kutinë e Preferencave, mund t'i shtosh ato në një dosje duke i vendosur artikujt njëri mbi tjetrin. Për ta riemërtuar dosjen, hape dhe prek shiritin e titullit të dosjes për të shkruar emrin e ri.

**Personalizimi i sfondit të ekranit**

Shtyp gjatë hapësirën e zbrazët në ekranin Kryesor, më pas prek **SFONDET**, ose shko te **Cilësimet > Ekrani > Sfondi** për të personalizuar sfondin.

## 1.3.6 Miniaplikacionet dhe aplikacionet e përdorura së fundi

**Referimi i miniaplikacioneve**

Shtyp gjatë një fushë boshe në ekranin Kryesor, më pas prek **MINIAPLIKACIONET** për të shfaqur të gjitha miniaplikacionet.

Prek miniaplikacionin e zgjedhur dhe zvarrite në pozicionin e dëshiruar.

**Referimi i aplikacioneve të përdorura së fundi**

Prek tastin Pamja e përgjithshme për të shfaqur aplikacionet e përdorura së fundi. Prek një miniaturë për të hapur aplikacionin ose rrëshqite majtas ose djathtas për ta hequr nga lista.






Prek në fund të ekranit për të mbyllur gjitha aplikacionet që po ekzekutohen.

## 1.3.7 Rregullimi i volumit

**Përdorimi i tastit të volumit**

Shtyp tastin e **Volumit** për të rregulluar volumin. Për të aktivizuar regjimin dridhje, shtyp tastin **Volumi poshtë** derisa telefoni të dridhet. Shtyp tastin **Volumi poshtë** edhe një herë për të aktivizuar regjimin **Mos shqetëso**.

**Përdorimi i menysë së cilësimeve**

Prek nga ekrani Kryesor për të hapur listën e aplikacioneve, më pas shko te **Cilësimet > Tingulli dhe njoftimet**. Mund të rregullosh volumin e medias, alarmeve, thirrjeve, njoftimeve, etj. sipas preferencave të tua.

# 2 Shkrimi i tekstit..............................

## 2.1 Përdorimi i tastierës virtuale

**Cilësimet e tastierës virtuale**

Shko te **Cilësimet > Gjuha dhe hyrja**, zgjidh tastierën që dëshiron të konfigurosh dhe një seri cilësimesh do të vihen në dispozicion.

**Ndryshimi i orientimit të tastierës virtuale**

Ktheje telefonin anash ose vertikalisht për të rregulluar orientimin e tastierës virtuale. Mund ta rregullosh duke ndryshuar cilësimet (shko te **Cilësimet > Ekrani**, shëno kutinë e kontrollit të **Rrotullo ekranin automatikisht** [(1)] ose prek **Kur pajisja rrotullohet > Rrotullo përmbajtjen e ekranit** [(2)].)

### 2.1.1 Tastiera Android




(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F) PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U).

(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).



## 2.2 Redaktimi i tekstit

Mund të redaktosh tekstin që ke futur.

- Shtyp gjatë tekstin që dëshiron të redaktosh.
- Zvarrit skedat për të ndryshuar zgjedhjen e theksuar.
- Do të shfaqen opsionet në vijim: **ZGJIDH TË GJITHË** , **PRIT**, **KOPJO** dhe **NDAJ**.







**Gjithashtu mund të shtosh tekst të ri**

- Prek ku do të shkruash ose shtyp gjatë një hapësirë bosh, kursori do të ndriçojë dhe skeda do të shfaqet. Zvarrit hapësirën për të lëvizur kursorin.
- Nëse ke prerë ose kopjuar ndonjë tekst, prek butonin për të shfaqur ikonën **NGJIT** që të lejon të ngjitësh çdo tekst që ke kopjuar më parë.



# 3 Thirrja, Regjistri i thirrjeve dhe Kontaktet

## 3.1 Telefonata

### 3.1.1 Kryerja e një thirrjeje

Për të bërë një telefonatë kur telefoni është i ndezur, shko tek ekrani Kryesor dhe prek ikonën e Telefonit në shiritin Të preferuarat.









Shkruaj numrin që dëshiron nga tastiera e numrave ose përzgjidh një kontakt nga **Regjistri i thirrjeve** ose **Kontaktet** duke prekur butonat, pastaj prek për të bërë thirrjen.

Numri që fute mund të ruhet te **Kontaktet** duke prekur ikonën **Krijo kontakt të ri** ose ikonën **Shto te një kontakt** .

Nëse bën një gabim, mund t'i fshish shifrat e pasakta duke prekur .

Për të mbyllur thirrjen, prek .

#### Thirrjet ndërkombëtare

Për të formuar thirrje ndërkombëtare shtyp gjatë 0 për të futur "+", pastaj fut prefiksin ndërkombëtar të shtetit të ndjekur nga numri i plotë i telefonit dhe prek .

#### Thirrja e urgjencës

Nëse telefoni ka mbulim me rrjet, formo numrin e emergjencës dhe prek për të bërë një telefonatë emergjence. Kjo funksionon edhe pa një kartë SIM dhe pa futur kodin PIN.

### 3.1.2 Përgjigjja ose refuzimi i një thirrjeje





Kur merr një thirrje:

- Rrëshqit ikonën në të djathtë për t'u përgjigjur;

- Rrëshqit ikonën në të majtë për ta refuzuar;
- Rrëshqit ikonën lart për ta refuzuar thirrjen duke dërguar një mesazh të paracaktuar.

Për të vendosur në heshtje thirrjet hyrëse, shtyp tastin e **Volumit lart/poshtë** ose ktheje telefonin përmbys (kur është aktivizuar opsioni**Ktheje përmbys për ta vendosur në heshtje** te **Cilësimet\Gjestet\Kthe përmbys për ta heshtur**).

### 3.1.3 Thirrja e postës zanore

Posta zanore është ofrohet nga rrjeti të shmangur humbje të thirrjeve. Funksionon si një sekretari telefonike që mund t'i drejtohesh në çdo kohë.

Për të dëgjuar postën zanore, shtyp gjatë 1 në tastierën e numrave.

Për të vendosur numrin e postës zanore, prek ikonën ⋮ dhe shko te **Cilësimet > Cilësimet e thirrjes > Posta zanore**.

Kur merr një postë zanore, një ikonë e re poste zanore do të shfaqet në shiritin e Statusit. Zvarrit poshtë panelin e njoftimeve dhe prek **Postë e re zanore** për ta hapur.

### 3.1.4 Gjatë një thirrje

Për të rregulluar volumin gjatë një thirrje, shtyp tastin **Volumi lart/poshtë** .






Përfundo thirrjen e tanishme.

Prek një herë që të aktivizosh altoparlantin gjatë thirrjes së tanishme. Prek këtë ikonë përsëri të çaktivizosh altoparlantin.

Prek një herë për të vendosur në heshtje thirrjen e tanishme. Prek këtë ikonë përsëri të bësh me zë thirrjen.

Shfaq tastierën e numrave.

Prek një herë për të vendosur në pritje thirrjen e tanishme. Prek këtë ikonë përsëri për të rikthyer thirrjen.

Hap opsionet **Shto thirrje** ose **Nis regjistrimin**.

Për të shmangur shtypjen aksidentale të ekranit gjatë një telefonate, ekrani do të kyçet automatikisht kur vendos telefonin në afërsi të veshit; dhe ai do të zhbllokohet kur telefoni i largohet veshit.

### 3.1.5 Menaxhimi i thirrjeve shumëfishe

Me këtë telefon mund të manovrosh thirrje shumëfishe në të njëjtën kohë.

**Thirrje konferencë** [1]

Mund të konfigurosh një thirrje konference si vijon:

- Kryej një thirrje pjesëtarit të parë të thirrjes konferencë.
- Prek ⋮ dhe zgjidh **Shto thirrje**.
- Shkruaj numrin e telefonit të personit që dëshiron të shtosh në konferencë dhe prek . Gjithashtu mund të shtosh pjesëmarrës nga **Regjistri i thirrjeve** ose **Kontaktet**.
- Prek ⋮ dhe zgjidh **Bashko thirrjet** për të nisur një thirrje konferencë.
- Prek për të përfunduar thirrjen konferencë dhe për të shkëputur të gjithë telefonuesit.

[1] Në varësi të operatorit të rrjetit.

### 3.1.6 Cilësimet e thirrjes

Prek ⋮ dhe zgjidh **Cilësimet** nga ekrani i Telefonit, opsionet e mëposhtme janë të disponueshme:

**Shfaq opsionet**

- **Rendit sipas** Për të vendosur shfaqjen e kontakteve sipas Emrit ose Mbiemrit
- **Formati i emrit** Për të vendosur formatin e emrit sipas Emrit në fillim ose Mbiemrit në fillim.

**Përgjigjet e shpejta**

- Për të redaktuar përgjigjet e shpejta të cilat do të përdoren kur refuzon një thirrje me mesazhe.

**Cilësimet e thirrjes**

- Posta zanore

  **Shërbimi:** Hap një kuti dialoguese ku mund të zgjedhësh shërbimin e postës zanore të operatorit ose një shërbim tjetër.

  **Konfigurimi:** Nëse je duke përdorur shërbimin e postës zanore të operatorit, kjo hap një kuti dialoguese ku mund të fusësh numrin e telefonit për ta përdorur për të dëgjuar dhe menaxhuar postën zanore.

  **Tingulli:** Për të zgjedhur tingullin e njoftimit për postën zanore hyrëse.

  **Dridhje:** Shëno kutinë e kontrollit për të aktivizuar dridhjen vjen një postë zanore hyrëse.

- **Numrat Formues të Fiksuar**

  Numrat Formues të Fiksuar (NFF) është një regjim shërbimi i SIM, ku thirrjet dalëse kufizohen në një bashkësi numrash telefoni. Këta numra janë shtuar në listën FDN. Aplikacioni më i zakonshëm praktik i FDN është për prindërit për të kufizuar numrat e telefonit të cilët fëmijët e tyre mund të telefonojnë.

  Për arsye sigurie, do të të kërkohet të aktivizosh FDN duke shtypur SIM PIN2 që zakonisht ofrohet nga operatori i shërbimit ose krijuesi i SIM.

- **Transferimi i thirrjes**

  Për të paraqitur se si transferohen thirrjet kur je i zënë, kur nuk përgjigjesh apo nuk je i arritshëm.



- **Bllokimi i thirrjeve**

  Mund të aktivizosh ose çaktivizosh bllokimin e thirrjeve për thirrjet dalëse dhe hyrëse. Opsionet e mëposhtme janë të disponueshme:

  **Të gjitha thirrjet dalëse:** Do të bllokohen të gjitha thirrjet dalëse.

  **Thirrjet dalëse ndërkombëtare:** Do të bllokohen thirrjet dalëse ndërkombëtare.

  **Ndërkombëtare përveç atyre drejt vendit tënd:** Do të bllokohen thirrjet ndërkombëtare përveç atyre drejt vendit të abonimit.

  **Të gjitha thirrjet hyrëse:** Do të bllokohen të gjitha thirrjet hyrëse.

  **Thirrjet hyrëse gjatë roaming:** Thirrjet hyrëse do të bllokohen kur je jashtë vendit.

  **Anulo të gjitha:** Çaktivizo të gjitha bllokimet e thirrjeve.

  **Ndrysho fjalëkalimin e bllokimit:** Ndrysho fjalëkalimin fillestar të bllokimit për aktivizimin e bllokimit të thirrjeve.

- **Cilësimet shtesë**

  **Identifikimi i thirrësit:** Telefoni do të përdorë cilësimet e paracaktuara të operatorit për të shfaqur numrin tënd në thirrjet dalëse.

  **Pritja e thirrjes:** Shëno kutinë e kontrollit për të të njoftuar gjatë një thirrjeje për një thirrje të re hyrëse.

  **Statusi i pritjes së thirrjes:** Hap një dialog ku mund të kontrollosh stastusin e pritjes së thirrjes.

## 3.2 Regjistër thirrjesh

Mund të hapësh historikun e thirrjeve duke prekur 🕓 nga ekranin i Telefonit.

Prek një kontakt ose një numër për veprime të mëtejshme.

Mund të shikosh informacionin e detajuar të një telefonate, mund të ritelefonosh ose të thërrasësh mbrapsht një kontakt ose numër, etj.

Për të parë të gjithë memorien e thirrjeve, prek **Shiko historikun e plotë të thirrjeve** në fund të ekranit.

Prek ⋮ dhe zgjidh **Fshi** ose **Pastro historikun e thirrjeve** për të fshirë regjistrat e padëshiruar të thirrjeve.

## 3.3 Kontaktet........................................................

Mund të shohësh dhe krijosh kontakte në telefon duke i sinkronizuar këto me kontaktet e tua të Gmail ose aplikacioneve të tjera në internet ose në telefon.

### 3.3.1 Referimi i kontakteve

Për të parë kontaktet, prek skedën e Aplikacionit në ekranin Kryesor, më pas zgjidh **Kontaktet**.




**Fshirja e kontakteve**

Shtyp gjatë kontaktin që dëshiron të fshish derisa fotoja e kontaktit të bëhet , më pas prek dhe zgjidh **Fshi**.

Kontakti që ke fshirë do të hiqet gjithashtu nga aplikacionet e tjera në telefon ose ueb herën tjetër që do të sinkronizosh telefonin.

Prek për të shfaqur menynë e opsioneve të listës së kontakteve.

Opsionet e mëposhtme janë të disponueshme:



- **Kontaktet për t'u shfaqur** Zgjidh cilat kontakte të shfaqen.
- **Importo/Eksporto** Importo ose eksporto kontakte mes llogarive, telefonit, kartës SIM, hapësirës ruajtëse të brendshme dhe kartës SD.
- **Grupet** Shiko ose krijo grupe kontakti
- **Llogaritë** Menaxho sinkronizimin e cilësimeve për llogari të ndryshme.
- **Cilësimet** Hap cilësimet e shfaqjes së kontakteve.
- **Blloko listën e kontakteve** Shfaq kontaktet e bllokuara. Mund të zhbllokosh gjithashtu kontaktet e dëshiruara duke prekur ikonën korresponduese të aplikacionit.

### 3.3.2 Shtimi i një kontakti

Prek në listën e kontakteve për të krijuar një kontakt të ri.




Lëviz lart dhe poshtë ekranin për të lëvizur nga një fushë në tjetrën.

**Shto/hiq nga Të preferuarat** [(1)]

Për të shtuar një kontakt te të preferuarit, mund të prekësh një kontakt për të hapur ekranin e detajeve pastaj prek ☆ për të shtuar kontaktin te të preferuarit.

Për të hequr një kontakt nga të preferuarat, prek ★ në ekranin e detajeve të kontaktit.

### 3.3.3 Redaktimi i kontakteve

Për të redaktuar informacionin e kontaktit, prek në ekranin e detajeve të kontaktit.

Kur të mbarosh, prek për të ruajtur.

**Ndrysho numrin e parazgjedhur të telefonit të një kontakti**

Numri i parazgjedhur i telefonit (numri që ka prioritet kur bëhet një thirrje ose kur dërgohet një mesazh) gjithmonë do të shfaqet poshtë emrit të kontaktit.

Për të ndryshuar numrin e parazgjedhur të telefonit, prek gjatë numrin që dëshiron të vendosësh si numër të paracaktuar nga ekrani i detajeve të kontaktit, pastaj zgjidh **Cakto të parazgjedhur**. Më pas do të shfaqet një ikonë përpara numrit.

Kjo zgjedhje është në dispozicion vetëm kur kontakti ka më shumë se një numër.

(1) Vetëm kontaktet e telefonit dhe të llogarisë mund të shtohen te Të preferuarat.



### 3.3.4 Përdorimi i kontaktit të shpejtë për Android

Prek një kontakt për të hapur Kontaktin e shpejtë për Android, më pas mund të prekësh ose numrin për të kryer thirrje, ose prek për të dërguar një mesazh.




Ikonat e disponueshme në panelin e kontaktit të shpejtë varen nga informacioni që ke për kontaktin dhe aplikacionet dhe llogaritë në telefon.

### 3.3.5 Importim, eksportim dhe ndarje e kontakteve

Nga pamja e ekranit Kontaktet, prek ⋮ për të hapur menynë e opsioneve, prek **Importo/Eksporto**, pastaj zgjidh kontaktet për importim/eksportim kontaktet nga/te llogaritë e tua, karta SIM, Telefoni, memoria e brendshme, karta SD, etj.

Për të importuar/eksportuar një kontakt të vetëm nga/te karta juaj SIM, zgjidh kontaktin që dëshiron të importosh/eksportosh dhe prek **OK** për të konfirmuar.

Mund të ndash një kontakt të vetëm ose kontakte me të tjerët duke u dërguar kartën "vCard" të kontaktit përmes "Bluetooth", "Gmail" etj.

Për të bërë këtë, prek një kontakt që do të ndash, prek ikonën ⋮ dhe **Ndaj** nga ekrani i detajeve të kontaktit, pastaj zgjidh një aplikacion për të kryer këtë veprim.

### 3.3.6 Shfaqja e kontakteve

Mund të konfigurosh cilin grup të kontakteve dëshiron të shfaqësh në listën e Kontakteve. Prek ⋮ dhe pastaj **Kontaktet për t'u shfaqur** nga ekrani i listës së kontakteve, pastaj mund të zgjedhësh cilat kontakte të shfaqen.

Prek ⋮ dhe pastaj **Cilësimet** për të renditur listën sipas **Emrit** ose **Mbiemrit** si edhe të formatosh emrin sipas **Emrit në fillim** ose **Mbiemrit në fillim**.

### 3.3.7 Bashkimi/Ndarja e kontakteve [(1)]

Për të shmangur duplikimin e informacionit, mund të shtosh detaje të kontakteve te një kontakt ekzistues.

Prek kontaktin që dëshiron t'i shtosh informacion, prek ✎ për të hyrë në ekranin e modifikimit të kontaktit, më pas prek ⋮ dhe zgjidh **Bashko**.

Pastaj do të të kërkohet të zgjedhësh kontaktin informacionin e të cilit dëshiron të bashkosh me kontaktin e parë.

Kur të përfundosh, informacioni nga kontakti i dytë do t'i shtohet të parit dhe kontakti i dytë nuk do të shfaqet më në listën e kontakteve.

(1) E aplikueshme vetëm për kontaktet e telefonit.



Për të ndarë informacionin e kontaktit, prek kontaktin informacionin e të cilit dëshiron të ndash, prek ✎ për të hyrë në ekranin e modifikimit të kontaktit, më pas prek ⋮ dhe zgjidh **Ndaj**, prek **OK** për të konfirmuar.

### 3.3.8 Sinkronizimi i kontakteve në disa llogari

Kontaktet, të dhënat dhe informacione të tjera mund të sinkronizohen nga disa llogari, në varësi të aplikacioneve të instaluara në telefon.

Për të shtuar një llogari, prek ⋮ nga lista e kontakteve dhe më pas zgjidh **Llogaritë > Shto llogari**.

Do të të kërkohet të zgjedhësh llojin e llogarisë që je duke shtuar, si Google, Personal (MAP), etj.

Ashtu si me konfigurimet e llogarisë, duhet të fusësh informacion të detajuar, si emër përdoruesi, fjalëkalim, etj.

Mund të heqësh një llogari dhe të gjithë informacionin lidhur me të nga telefoni. Prek llogarinë që dëshiron të fshish, prek ⋮ dhe zgjidh **Hiq llogari**, më pas konfirmoje.

#### Sinkronizimi automatik

Në ekranin **Llogaritë**, prek ⋮ dhe shëno kutinë **Sinkronizo automatikisht të dhënat** për ta aktivizuar.

# 4 Mesazhet ....................................

Mund të krijosh, redaktosh dhe të marrësh mesazhe SMS dhe MMS me telefonin tënd.

Shko në ekranin Kryesor dhe prek ikonën Mesazhet në shiritin Të preferuarat.

## 4.1 Shkrimi i një mesazhi të ri

Në ekranin e listës së mesazheve, prek ikonën e mesazhit të ri për të shkruar mesazhe të reja/multimedia.




Për kontaktet e ruajtura, prek fotografinë e kontaktit për të hapur panelin e kontaktit të shpejtë për të komunikuar me kontaktin. Për kontaktet e paruajtura, prek për të shtuar numrin te **Kontaktet.**



**Dërgimi i një mesazhi me tekst**

Fut emrin ose numrin e telefonit të marrësit në shiritin e marrësit ose prek për të shtuar marrës, pastaj prek shiritin e përmbajtjes për të futur tekstin e mesazhit. Pasi të mbarosh, prek për të dërguar mesazhin me tekst.

Një mesazh SMS me më shumë se 160 karaktere faturohet si disa SMS. Një numërator mbi ikonën e dërgimit do të të kujtojë për numrin e karaktereve të mbetura që mund të futen në një mesazh.

Germat specifike (p.sh. me theks) rrisin madhësinë e mesazhit SMS, gjë e cila mund të bëjë që marrësit t'i dërgohen disa SMS.

**Dërgimi i një mesazhi multimedia**

MMS mundëson të dërgimin e videoklipeve, figurave, fotove, kontakteve, prezantimeve dhe tingujve drejt celularëve të tjerë të përputhshëm dhe adresave të emailit.

Një SMS do të konvertohet automatikisht në MMS kur në mesazh bashkëngjiten skedarë të mediave (foto, video, audio, prezantime etj.) ose kur shtohet subjekti ose adresa emaili.

Për të dërguar një mesazh multimedia, fut numrin ose emrin e telefonit të marrësit në shiritin e marrësit, prek shiritin e përmbajtjes për të futur tekstin e mesazhit.

Prek për të hapur menynë e opsioneve, më pas prek **Shto subjekt** për të shtuar një subjekt.

Prek për të bashkëngjitur një fotografi, video, audio, etj.

Kur të mbarosh, prek për të dërguar mesazhin multimedial.

**Opsionet e shtimit:**

- **Kap fotografinë** Hap Kamerën për të bërë një fotografi të re për ta bashkëngjitur.
- **Kap video** Hap Video-regjistruesin për të bërë një video të re për ta bashkëngjitur.
- **Regjistro audio** Fut regjistruesin e mesazhit zanor për të regjistruar një mesazh zanor për ta bashkëngjitur.
- **Kontakti** Hyr te Kontaktet për të zgjedhur një kontakt si bashkëngjitje.
- **Fotografitë** Hap Galerinë ose Menaxherin e skedarëve për të zgjedhur një fotografi si bashkëngjitje.
- **Videot** Hap Galerinë ose Menaxherin e skedarëve për të zgjedhur një video si bashkëngjitje.
- **Audio** Prek për të zgjedhur një skedar audio si bashkëngjitje.
- **Kalendari** [(1)] Hap Kalendarin për të zgjedhur një ose më shumë ngjarje për ta bashkëngjitur.
- **Prezantimi** Hyr në ekranin e redaktimit të prezantimit, prek **Shto pamje** për të krijuar një pamje të re ose prek një pamje ekzistuese për ta redaktuar.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F).






## 4.2 Menaxhimi i mesazheve

Kur mbërrin një mesazh i ri, një ikonë do të shfaqet në shiritin e statusit si një njoftim. Zvarrit poshtë shiritin e statusit për të hapur panelin e Njoftimeve, prek mesazhin e ri për ta hapur ose lexuar atë. Gjithashtu mund të hapësh aplikacionin e Mesazhet dhe prek mesazhin për ta hapur atë.

Mesazhet shfaqen si një bisedë.

Prek një mesazh për të hyrë në ekranin e kompozimit të mesazheve:

- Prek për të telefonuar numrin;
- Prek për të ruajtur numrin te **Kontaktet** ose për të parë detajet e kontaktit nëse numri është ruajtur;
- Për t'iu përgjigjur një mesazhi, shkruaj tekstin ose prek dhe zgjidh të fusësh tekst të shpejtë, kontakt, etj. prek .
- Nëse shtyp gjatë një mesazh, do të disponohen mesazhet e mëposhtme: kopjo tekstin , transfero , fshi , menyja e opsioneve të tjera , etj.

## 4.3 Rregullimi i cilësimeve të mesazhit

Në ekranin e listës së mesazheve, prek tastin ⋮ dhe zgjidh **Cilësimet**.

**SMS aktivizuar**

Hap dialogun e opsioneve ose prek **Aplikacioni SMS** [1] për të ndryshuar aplikacionin e parazgjedhur për SMS.

**Mesazhet me tekst (SMS)**

- **Kërko raportin e dorëzimit** Shëno kutinë e kontrollit për të kërkuar një raportim dorëzimi për çdo mesazh me tekst që dërgon.
- **Menaxho mesazhet e kartës SIM** Prek për të menaxhuar mesazhet me tekst të ruajtura në kartën SIM.
- **Redakto tekstin e shpejtë** Prek për të shtuar ose redaktuar shabllone mesazhi.
- **Qendra e shërbimit SMS** Hap një dritare kërcyese për të shfaqur numrin e qendrës së shërbimit.
- **Periudha e vlefshmërisë** Zgjidh një periudhë vlefshmërie, gjatë së cilës operatori i rrjetit do të vazhdojë ta dërgojë mesazhin nëse nuk mund të dorëzohet menjëherë.
- **Vendndodhja e hapësirës ruajtëse të SMS** Zgjidh telefonin ose kartën SIM si vendndodhje të hapësirës ruajtëse për SMS.
- **Menaxhimi i alfabetit** Zgjidh një regjim Alfabeti.
- **Nënshkrimi në SMS [1]** Shëno kutinë e verifikimit për të aktivizuar nënshkrimin në SMS.
- **Redakto nënshkrimin në SMS [1]** Prek për të hapur ekranin e redaktimit të nënshkrimit në SMS.

[1] Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F)
PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U).



**Mesazhi multimedial (MMS)**

- **Mesazhet në grup** Kur aktivizohet, do të jesh në gjendje të dërgosh një mesazh të vetëm te disa marrës.
- **Kërko raportin e dorëzimit** Do të kërkojë një raportim dorëzimi për çdo mesazh multimedia që dërgon.
- **Kërko raportin e leximit** Do të kërkojë një raportim se kur secili nga marrësit e ka lexuar një mesazh multimedia të dërguar nga ti.
- **Dërgo raportin e leximit** Do të dërgojë automatikisht një raport leximi te dërguesi nëse ai/ajo e ka kërkuar këtë.
- **Nxirr automatikisht** Do të shkarkojë automatikisht mesazhin e plotë MMS (përfshirë trupin e mesazhit dhe bashkëngjitjen) në telefonin tënd. Për të shkarkuar vetëm titullin e mesazhit MMS, hiq shënimin e kutisë së kontrollit.
- **Nxirr automatikisht në roaming** Shëno kutinë e kontrollit për të aktivizuar nxjerrjen automatike në roaming.
- **Regjimi i krijimit** Përzgjidh regjimin e krijimit.
- **Madhësia maksimale e mesazhit** Prek për të ndryshuar madhësinë maksimale të mesazheve.
- **Prioriteti** Për vendosjen e prioritetit.

**Njoftimet**

- **Njoftimet e mesazheve** Do të shfaqë njoftimet e mesazhit në shiritin e statusit.
- **Heshtje** Zgjidh një kohëzgjatje për të vendosur në heshtje telefonin kur ka një mesazh të ri ose çaktivizo heshtjen duke shënuar kutinë e kontrollit të **Heshtjes**.
- **Tingulli** Zgjidh një zile si tonalitet të njoftimit të mesazheve të reja.
- **Njoftimet kërcyese** Do të shfaqë njoftimet kërcyese nëse është e aktivizuar.

**Të përgjithshme**

- **Madhësia e fontit të mesazhit** Zgjidh një madhësi fonti për mesazhin.
- **Fshi mesazhet e vjetra** Do të fshijë mesazhet e vjetra kur arrihet numri maksimal i mesazheve të ruajtura. Për ta çaktivizuar funksionin, hiq shënimin e kutisë së kontrollit.
- **Kufiri i mesazhit tekst** Prek për të vendosur numrin e mesazheve tekst për tu ruajtur për bisedë.
- **Limiti i mesazhit multimedial** Prek për të vendosur numrin e mesazheve multimediale për tu ruajtur për bisedë.
- **Aktivizo zilen CB** Shëno/hiq shënimin e kutisë së kontrollit për të aktivizuar/çaktivizuar zilen e celularit.
- **Zgjidh zilen CB** Zgjidh një zile për transmetimin celular.
- **Transmetimi celular** Për të aktivizuar ose çaktivizuar shërbimin transmetim celular ose për të zgjedhur gjuhën dhe kanalin për të.
- **Aktivizo WAP PUSH** Shëno/hiq shënimin e kutisë së kontrollit për të aktivizuar/çaktivizuar marrjen e mesazheve me shtytje nga rrjeti.



# 5 Kalendari, Ora e alarmit dhe Makina llogaritëse .........................

## 5.1 Kalendari........................................  (1)  (2)

Përdor kalendar për të ndjekur mbledhjet e rëndësishme, takimet, etj.

Për ta hapur Kalendarin, prek skedën e Aplikacionit nga ekrani Kryesor, pastaj prek **Kalendari**.

### 5.1.1 Shfaqje me shumë mënyra

**PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F)**




**PIXI 4 (5) (5045X, 5045D)**

Për të ndryshuar pamjen e Kalendarit, prek ikonën përveç titullit të muajit për të hapur pamjen e muajit ose prek dhe zgjidh **Programi, Dita, 3-ditë, Javë** ose**Muaj** për të hapur pamje të ndryshme. Prek ikonën (3) për t'u kthyer në pamjen Sot.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F).
(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D, 5010X, 5010D, 5010U).
(3) Numri tregon datën.




### 5.1.2 Për të krijuar ngjarje të reja

Mund të shtosh ndodhi të reja nga çdo shfaqje e Kalendarit.

- Prek .
- Plotëso të gjithë informacionin e kërkuar për këtë ngjarje të re. Nëse ajo është ngjarje për gjithë ditën, mund të zgjedhësh çelësin **GJITHË DITËN**.
- Fto njerëz në ngjarje. Fut adresat e emailit të të ftuarve dhe ndaji me presje. Më pas të gjithë të ftuarit do të marrin një ftesë nga Kalendari dhe Emaili (1).
- Kur të përfundosh, prek (2) ose **RUAJ** (1) nga pjesa e sipërme e ekranit.

Para se të mund të shtosh një ngjarje, duhet të kesh të paktën një llogari Kalendari dhe të bësh një kalendar të dukshëm (1).

(1) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D, 5010X, 5010D, 5010U).
(2) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F).



### 5.1.3 Për të fshirë ose redaktuar një ngjarje

- Prek një ngjarje për të hapur ekranin e detajeve, më pas prek (1) / (2) për të redaktuar ngjarjen, ose prek (1) ose **FSHI** (2) për të fshirë.

### 5.1.4 Kujtesë ngjarjeje

Nëse është vendosur një kujtesë për një ngjarje, ikona e ngjarjes së ardhshme (1) / (2) do të shfaqet në shiritin e statusit si një njoftim, kur të arrijë koha e kujtesës.

Prek dhe zvarrit poshtë shiritin e statusit për të hapur panelin e njoftimeve, prek emrin e ngjarjes për të parë listën e njoftimeve në Kalendar.

Prek tastin **Prapa** për të mbajtur kujtesat në pritje në shiritin e statusit dhe panelin e njoftimeve.

## 5.2 Ora ..........................................................................

Telefoni celular ka një orë të integruar. Për ta hapur atë, prek skedën e Aplikacionit nga ekrani Kryesor, pastaj prek **Ora**.

### 5.2.1 Alarmi

**Për të vendosur një alarm**

Nga ekrani **Ora**, prek për t'u futur në ekranin **Alarmet**, pastaj prek për të shtuar një alarm të ri. Opsionet vijuese do të shfaqen:

- **Ora** Prek numrat për të vendosur orarin e alarmit.
- **Përsërit** Shëno kutinë e kontrollit të Përsërit dhe më pas zgjidh ditët që dëshiron alarmin të bjerë.
- **Zilja** Zgjidh një zile alarmi.
- **Dridhje** Shëno kutinë e kontrollit për të aktivizuar/çaktivizuar vibrimin.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F).
(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D, 5010X, 5010D, 5010U).

- **Etiketa** Prek për të vendosur emërtimin për alarmin.

Prek poshtë një alarmi ekzistues për të zgjeruar ekranin e redaktimit. Prek që të fshish alarmin.

**Për të rregulluar cilësimet e alarmit**

Prek nga ekrani **Alarmet**. Opsionet në vijim do të jenë të disponueshme nën **Cilësimet**:

**Ora**

- **Stili** Prek për të vendosur stilin **Analog** ose **Dixhital**.
- **Ora automatike lokale** Do të shtojë automatikisht një orë lokale kur udhëton jashtë. Për ta çaktivizuar, hiq shënimin e kutisë së kontrollit.
- **Zona e orës lokale** Prek për të vendosur zonën e orës lokale.

**Alarmet**

- **Heshtje pas** Zgjidh një orar heshtjeje.
- **Periudha e dremitjes** Prek për të zgjedhur periudhën e dremitjes.
- **Volumi i alarmit** Prek për të vendosur volumin e alarmit.
- **Butonat e volumit** Regjistro sjelljet e butonave të volumit lart/poshtë kur bie alarmi: **Dremit, Largo,** ose **Mos bëj asgjë**.
- **Fillo javën në** Zgjidh të fillosh javën në ditën **E shtunë, E diel** ose **E hënë**.
- **Kthe përmbys për ta aktivizuar** [1] Aktivizo çelësin për të aktivizuar sjelljen e kthimit përmbys si **Dremit** ose **Ndalo** të alarmit.

## 5.2.2 Ora botërore

Për të parë orën botërore, prek në ekranin **Ora**.

[1] Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F) PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U).



- Prek për të shtuar një brez kohor nga lista.

## 5.2.3 Numërimi mbrapsht

Nga ekrani **Ora**, prek për të hyrë në ekranin **Numërimi mbrapsht**.

Prek shifrat për të vendosur kohën e numërimit mbrapsht. Shkruaj kohën në sekuencën në orë, minuta dhe sekonda.

Prek për të nisur numërimi mbrapsht.




## 5.2.4 Kohëmatësi

Nga ekrani **Ora**, prek për të hyrë në ekranin **Kohëmatësi**.

Prek për të nisur kohëmatësin.

**Shfaq një listë të regjistrimeve sipas kohës së përditësuar:** Prek .

**Pauzë:** Prek .

**Ndaj kohëmatësin përmes Bluetooth, Gmail, etj.:** Prek .

**Fshij regjistrimin:** Prek .

## 5.3 Makina llogaritëse.......................................

Për të zgjidhur problemet matematike me **Makinën llogaritëse**, prek skedën Aplikacioni nga ekrani Kryesor, më pas prek **Makina llogaritëse**.

Ka dy panele të disponueshme: Llogaritja bazë dhe llogaritja shkencore.

Për të ndryshuar midis paneleve, zgjidh një nga dy rrugët që vijojnë:

- Rrëshqit ekranin e llogaritjes bazë në të majtë për të hapur llogaritjen shkencore.
- Ose ktheje pajisjen në orientim horizontal nga paneli bazë për të hapur llogaritjen shkencore. Ky opsion është i disponueshëm vetëm nëse është aktivizuar **Cilësimet > Ekrani > Rrotullo automatikisht ekranin** (1) ose **Kur pajisja rrotullohet** (2) **> Rrotullo përmbajtjen e ekranit**.







Formo një numër dhe veprimin aritmetik që do të kryhet, formo një numër të dytë, dhe pastaj prek "=" për të shfaqur rezultatin. Prek për të fshirë shifrat një nga një ose shtyp gjatë për t'i fshirë të gjitha njëherësh.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F) PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U).

(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).



# 6 Lidhja .............................................

Telefoni mund të lidhet në internet duke përdor GPRS/EDGE/3G/4G (1) ose Wi-Fi.

## 6.1 Lidhja me internetin

### 6.1.1 GPRS/EDGE/3G/4G (1)

Herën e parë që ndez telefonin me kartën SIM brenda, ajo do të konfigurojë automatikisht shërbimin e rrjetit celular: GPRS, EDGE , 3G ose 4G (1). Nëse rrjeti nuk është lidhur, mund të aktivizosh të dhënat celulare te **Cilësimet > Përdorimi i të dhënave**.

Për të kontrolluar lidhjen e rrjetit që po përdor, prek butonin e Aplikacionit në ekranin Kryesor, pastaj shko te **Cilësimet > Më shumë > Rrjetet celulare > Emrat e pikës hyrëse** ose **Operatorët e rrjetit**.

**Për të krijuar një pikë të re hyrjeje**

Një lidhje e re rrjeti celular mund t'i shtohet telefonit me hapat e mëposhtëm:

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te Cilësimet.

2 Prek **Më shumë > Rrjetet celulare > Emrat e pikës së hyrjes**.

3 Pastaj prek dhe **APN e re** për të shtuar APN të re.

4 Fut informacionin e kërkuar për APN.

5 Kur të mbarosh, prek tastin dhe **Ruaj**.

**Për të aktivizuar/çaktivizuar të dhënat roaming**

Mund të lidhesh ose shkëputesh me një shërbim të dhënash sipas nevojave kur je në roaming:

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

(1) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).

2 Prek **Më shumë > Rrjetet celulare > Roaming i të dhënave**.

3 Aktivizo çelësin për të lejuar përdorimin e të dhënave gjatë kohës që je në roaming. Çaktivizo çelësin për të shmangur tarifat e larta në roaming nëse nuk është nëpërdorim.

4.Kur të dhënat në roaming janë çaktivizuar, ende mund të kryesh shkëmbim të të dhënave me një lidhje Wi-Fi (shih **"6..1..2 Wi-Fi"**).

**Për të vendosur regjimin e rrjetit të preferuar**

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Prek **Më shumë > Rrjetet celulare > Lloji i rrjetit të preferuar**.

3 Zgjidh **UMTS/GSM (automatike)/Vetëm UMTS/Vetëm GSM** [1] ose **4G/3G/2G** [2] si regjimin e rrjetit të preferuar.

### 6.1.2 Wi-Fi

Mund të lidhesh me internetin kur telefoni është brenda zonës së mbulimit të një rrjeti me valë. "Wi-Fi" mund të përdoret në telefon edhe pa qenë e vendosur karta SIM.

**Aktivizimi i "Wi-Fi" dhe lidhja me një rrjet me valë**

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**, pastaj prek **Wi-Fi.**

2 Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar Wi-Fi.

3 Aktivizo Wi-Fi: informacionet e detajuara për të gjitha rrjetet e gjetura Wi-Fi shfaqen në seksionin e rrjeteve Wi-Fi.

4 Prek një rrjet Wi-Fi për t'u lidhur me të. Nëse rrjeti që ke zgjedhur është i sigurt, do të fusësh një fjalëkalim apo kredenciale tjera (kontakto me operatorin e rrjetit për detaje). Kur të përfundosh, prek **LIDHU**.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F) PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U).
(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).



**Për të aktivizuar njoftimet kur zbulohet një rrjet i ri**

Kur Wi-Fi është i aktivizuar dhe njoftimet e rrjetit janë aktivizuar, ikona Wi-Fi do të shfaqet në shiritin e statusit kurdo që telefoni zbulon një rrjet pa valë të disponueshëm brenda zonës. Hapat në vazhdim aktivizojnë funksionin e njoftimeve kur Wi-Fi është i aktivizuar:

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Prek Wi-Fi, pastaj prek tastin dhe zgjidh **Të avancuara**.

3 Prek çelësin **Njoftimet e rrjetit** për të aktivizuar/çaktivizuar këtë funksion.

**Për të shtuar një rrjet Wi-Fi**

Kur Wi-Fi është i ndezur, mund të shtosh një rrjet të ri Wi-Fi sipas preferencave të tua.

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Prek **Wi-Fi**, më pas prek dhe zgjidh **Shto rrjet**.

3 Fut emrin e rrjetit dhe çdo informacion të kërkuar rrjeti.

4 Prek **RUAJ**.

**Për të harruar një rrjet Wi-Fi**

Hapat në vazhdim parandalojnë lidhjet automatike në rrjete që nuk dëshiron t'i përdorësh më.

1 Aktivizo Wi-Fi, nëse nuk është tashmë aktiv.

2 Në ekranin Wi-Fi, shtyp gjatë emrin e rrjetit të ruajtur.

3 Zgjidh **Harro rrjetin** në dritaren që hapet.

## 6.2 Lidhja me pajisjet Bluetooth (1)

Bluetooth është një teknologji komunikimi pa tela me diapazon të shkurtër që mund ta përdorësh për të shkëmbyer të dhënat ose për t'u lidhur me pajisje të tjera Bluetooth për përdorime të ndryshme.

Për të shkëmbyer të dhënat, prek ⚙ në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet** pastaj prek **Bluetooth**. Pajisja jote dhe pajisje të tjera të disponueshme do të shfaqen në ekran.

**Për të ndezur Bluetooth**

Prek për të aktivizuar ose çaktivizuar këtë funksion.

Për ta bërë telefonin më të dallueshëm, mund të ndryshosh emrin e telefonit që u shfaqet të tjerëve.

1 Shko te **Cilësimet > Bluetooth**.

2 Prek ⋮ dhe zgjidh **Riemërto këtë pajisje**.

3 Fut një emër dhe prek **RIEMËRTO** për ta konfirmuar.

**Për të çiftuar/lidhur telefonin me një pajisje Bluetooth**

Për të shkëmbyer të dhëna me një pajisje tjetër, duhet të ndezësh Bluetooth dhe të çiftosh telefonin me pajisjen Bluetooth me të cilën dëshiron të shkëmbesh të dhëna.

1 Shko te **Cilësimet > Bluetooth**.

2 Prek ⋮ dhe zgjidh **Rifresko**.

3 Prek një pajisje të dëshiruar Bluetooth në listë.

4 Një dialog do të kërcejë, prek **ÇIFTO** për ta konfirmuar.

5 Nëse çiftëzimi është i suksesshëm, telefoni lidhet me pajisjen.

(1) Rekomandohet të përdorësh pajisjet Bluetooth ALCATEL, të cilat janë të testuara dhe të pajtueshme me telefonin tënd. Mund të shkosh te www.alcatel-mobile.com për më shumë informacion rreth kufjeve Bluetooth ALCATEL.



**Për t'u shkëputur/hequr çiftimin nga një pajisje Bluetooth**

1 Prek ⚙ pas emrit të pajisjes që dëshiron t'i heqësh çiftimin.

2 Prek **HARRO** për ta konfirmuar.

## 6.3 Lidhja me një kompjuter përmes USB-së

Me kabllon USB, mund të transferosh skedarët media dhe skedarë të tjerë mes telefonit dhe kompjuterit.

Për t'u lidhur:

1 Përdor kabllon USB të ofruar me telefonin për ta lidhur këtë të fundit me folenë USB të kompjuterit. Do të marrësh një njoftim "Lidhur si pajisje media" ose "USB për karikim".

2 Prek për të hapur njoftimin, më pas në dialogun tjetër, zgjidh mënyrën se si dëshiron të transferosh skedarët.

Para përdorimit të MTP-së, sigurohu që është instaluar drejtuesi (Windows Media Player 11 ose version më i ri).

**Për të lokalizuar të dhënat e transferuara ose të shkarkuara në hapësirën ruajtëse të brendshme:**

1 Prek skedën Aplikacionet nga ekrani kryesor për të hapur listën e aplikacioneve.

2 Hap **Menaxheri i skedarëve**.

Të gjitha të dhënat që ke shkarkuar ruhen te **Menaxheri i skedarëve**, ku mund të shohësh skedarët media (video, foto, muzikë dhe të tjera), mund të riemërtosh skedarët, të instalosh aplikacionet në telefon etj.

## 6.4 Ndarja e lidhjes së të dhënave celulare të telefonit

Mund ta ndash lidhjen e të dhënave të celularit me një kompjuter të vetëm përmes një fishe USB (shpërndarje me USB) ose me deri në tetë pajisje njëkohësisht duke e kthyer telefonin në një pikë hyrjeje Wi-Fi të lëvizshme ose nëpërmjet Bluetooth.

Ndarja e të dhënave mund të çojë në pagesa shtesë nga operatori i rrjetit. Tarifa shtesë mund të faturohen edhe në zonat me roaming.

**Për të ndarë lidhjen e të dhënave të telefonit nëpërmjet USB-së**

Përdor kabllon USB që ke marrë me telefonin për të lidhur telefonin me një portë USB në kompjuter.

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Shko te **Më shumë > Lidhja dhe pika shpërndarëse lëvizëse**.

3 Prek çelësin pas **Lidhja USB** për të aktivizuar/çaktivizuar këtë funksion.

**Për të ndarë lidhjen e të dhënave të telefonit si pikë shpërndarëse lëvizëse Wi-Fi**

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Shko te **Më shumë > Lidhja dhe pika shpërndarëse e lëvizshme > Pika shpërndarëse Wi-Fi**.

3 Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar këtë funksion.

**Për të ndarë lidhjen e të dhënave të telefonit nëpërmjet Bluetooth**

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Shko te **Më shumë > Lidhja dhe pika shpërndarëse lëvizëse**.

3 Aktivizo çelësin pas **Lidhja Bluetooth** për të aktivizuar këtë funksion.



**Për të riemërtuar ose siguruar pikën aktive të lëvizshme**

Kur një pikë shpërndarëse Wi-Fi është aktivizuar, mund të ndryshosh emrin e rrjetit Wi-Fi të telefonit (SSID) dhe të sigurosh rrjetin e tij Wi-Fi.

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Shko te **Më shumë > Lidhja dhe pika shpërndarëse e lëvizshme > Pika shpërndarëse Wi-Fi**.

3 Prek **Konfiguro pikën shpërndarëse Wi-Fi** për të ndryshuar rrjetin SSID ose vendosur sigurinë e rrjetit.

4 Prek **RUAJ**.

## 6.5 Lidhja me rrjete private virtuale

Rrjetet private virtuale (VPN-të) të lejojnë të lidhesh me burime brenda një rrjeti lokal të sigurt nga jashtë atij rrjeti. VPN-të zakonisht shpërndahen nga korporata, shkolla dhe institucione të tjera, kështu përdoruesit e tyre mund të përdorin burimet lokale të rrjetit kur nuk janë brenda atij rrjeti ose kur lidhen me një rrjet me valë.

**Për të shtuar një VPN**

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Shko te **Më shumë > VPN** dhe pastaj prek +.

3 Në ekranin që hapet, ndiq instruksionet nga administratori i rrjetit për të konfiguruar çdo komponent të cilësimeve VPN.

4 Prek **RUAJ**.

VPN shtohet në listën e ekranit të cilësimeve VPN.

Para se të shtosh një VPN, duhet të vendosësh një motiv kyçjeje të ekranit, kod PIN apo fjalëkalim për telefonin.

**Për t'u lidhur/shkëputur me një VPN**

Për t'u lidhur me një VPN:

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Shko te **Më shumë > VPN**.

3 Renditen VPN-të që ke shtuar; prek VPN më të cilën dëshiron të lidhesh.

4 Në dialogun që hapet, fut kredencialet e kërkuara dhe prek **LIDHU**.

Për t'u shkëputur:

Hap panelin e Njoftimeve dhe prek njoftimin përfundimtar për shkëputjen e VPN-së.

**Për të redaktuar/fshirë një VPN**

Për të redaktuar një VPN

1 Prek në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Shko te **Më shumë > VPN**.

3 Renditen VPN-të që ke shtuar; shtypi gjatë VPN që dëshiron të modifikosh.

4 Zgjidh **Modifiko profilin** në dritaren që hapet.

5 Pas modifikimit, prek **RUAJ**.

Për të fshirë:

Shtyp gjatë VPN-në që dëshiron të fshish, në dritaren që hapet, zgjidh **Fshi profilin**.



# 7 Aplikacione multimediale

## 7.1 Kamera

Telefoni celular është i pajisur me një Kamera për të bërë fotografi dhe për të xhiruar video.

Para se të përdorësh kamerën, sigurohu që të heqësh lenten mbrojtëse mbuluese para përdorimit për të shmangur ndikimin në cilësinë e fotos.

Për të shkrepur një foto kur telefoni është aktiv, prek **Kamera** në ekranin Kryesor.

Nëse telefoni është i kyçur, shtyp butonin e Energjisë dhe pastaj rrëshqit ikonën kamera në të majtë për të hapur kamerën.



**Për të nxjerrë një foto**

Ekrani vepron si gjetës pamjeje. Në fillim poziciono objektin ose pamjen në gjetësin e pamjeve, prek për të bërë foto e cila do të ruhet automatikisht. Mund të shtypësh gjithashtu gjatë për të shkrepur foto në seri.

**Për të regjistruar një video**

Prek poshtë djathtas në ekran për të filluar regjistrimin e videos. Mund të prekësh gjithashtu ikonën e madhe qendrore për të shkrepur një fotografi gjatë regjistrimit të videos.

Prek për të ndaluar regjistrimin. Videoja do të ruhet automatikisht.

### 7.1.1 Regjimi i shkrepjes

Rrëshqit në menynë e lundrimit për te regjimi i ndërrimit; Prek emrin e regjimit për të lundruar te gjetësi i pamjes.

**Regjimi i regjistrimit me kamerën e pasme**

- **Kodi QR** Hap skanimin e kodit QR.
- **PANO** Prek që të aktivizosh funksionin panoramik. Prek butonin e shkrepjes që të fillosh të bësh foto panoramike dhe lëviz telefonin në mënyrë të vazhdueshme përgjatë drejtimit të treguar nga linja në ekran. Pasi mbushet korniza e shikimit paraprak, telefoni do të ruajë automatikisht foton.
- **Normale** Regjimi i parazgjedhur i regjistrimit.
- **Polaroid** Kalo në shkrepjen Polaroid. Si parazgjedhje, Polaroid do të bashkojë dy shkrepje në një fotografi. Prek për të shfaqur më shumë opsione. Më pas prek për të përfshirë vetëm një shkrepje në fotografi ose për të bashkuar dy shkrepje në një fotografi ose për të mbyllur opsionet.
- **Zbukurimi i fytyrës** Prek për të aktivizuar zbukurimin e fytyrës gjatë shkrepjes.



- **HDR** Prek **HDR** në pjesën e sipërme të ekranit në mes për të aktivizuar funksionin HDR (High-Dynamic Range). Fotografitë HDR mund të kapin një gamë më të gjerë hijesh dhe ndriçimi duke kombinuar ekspozime të ndryshme (ki parasysh se kjo nuk është zakonisht e përshtatshme për fotografitë me gjëra që lëvizin me shpejtësi në to). Telefoni më pas do t'i ruajë automatikisht fotografitë HDR.

### 7.1.2 Cilësimet

- **Informacioni i vendndodhjes GPS** Aktivizo çelësin për të etiketuar fotografitë ose videot me informacionin e vendndodhjes. Nevojitet fillimisht të aktivizosh GPS dhe rrjetet celulare.
- **Ekspozimi** Zgjidh kohën e ekspozimit në dritaren që hapet.
- **Efekti i ngjyrave** Prek për të zgjedhur një efekt ngjyrash nëse nevojitet.
- **Regjimi i skenës** (1) Zgjidh regjimin e skenës mes **Automatike**, **Natë**, **Perëndim dielli**, **Party**, etj.
- **Balanca e të bardhës** Zgjidh një regjim balance të së bardhës.
- **Cilësitë e imazhit** Prek për të vendosur shkallën e **Mprehtësisë, Ngjyrimit, Thellësisë, Ndriçimit** dhe **Kontrastit**.
- **Rivendos të paracaktuarat** Rivendos cilësimet e kamerës në të paracaktuarat.

(1) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).

**Kamera**

Prek çelësat për të aktivizuar ose çaktivizuar **Tingullin e shkrepjes, Vonesën zero të shkrepjes, Dallimin e fytyrave, Shkrepjen e gjesteve, Shkrepjen e buzëqeshjes,** dhe **Dallimin automatik të skenës** kur shkrep një fotografi.

- **Kohëmatësi automatik** Prek për të vendosur kohëzgjatjen e pauzës përpara shkrepjes së fotografive.
- **Madhësia e fotos** Zgjidh madhësinë e fotografisë në dritaren që hapet.
- **Madhësia e paraafishimit** Prek për të vendosur madhësinë e paraafishimit në **Ekrani i plotë** ose **Standard (4:3)**.
- **ISO** ISO përcakton se sa i ndjeshëm është ndaj dritës sensori i imazheve. Sa më i ulët numri ISO, aq më e ngadaltë shpejtësia. Sa më i lartë numri ISO, aq më e shpejtë shpejtësia. Prek për të ndryshuar cilësimet e ISO në **Auto, 100, 200, 400, 800, 1600.**

**Video**

- **EIS** Veçoria e stabilizimit elektronik të imazhit (EIS) është e aktivizuar si parazgjedhje.. Ajo ndihmon me reduktimin e turbullimit që shoqëron lëvizjen e një kamere gjatë ekspozimit. Për ta çaktivizuar, çaktivizo butonin .
- **Mikrofoni** Mikrofoni është aktiv për regjistrimin e videove. Prek çelësin për ta çaktivizuar.
- **Modaliteti audio** Vendose modalitetin e audios si **Takim** ose **Normal**.
- **Intervali i kalimit të kohës** Zgjidh intervalin e kalimit të kohës ose çaktivizoje.
- **Kualiteti i videos** Vendos paraprakisht cilësinë e regjistrimit të videos.



## 7.2 Galeria

Galeria vepron si një lexues media për të shfaqur fotot dhe për të luajtur videot.

Për të hapur Galerinë, prek **Galerinë** nga ekrani Kryesor.




**Për të parë një foto/për të luajtur një video**

Fotot dhe videot shfaqen nga albumet te **Galeria**.



- Trokit mbi një album. Të gjitha fotografitë ose videot do të përhapen në ekran.
- Prek foton/videon për ta parë ose luajtur atë.
- Rrëshqit majtas ose djathtas për të parë foton/videon tjetër ose të mëparshme.

### Redaktimi i fotove

Mund të punosh me fotot duke i rrotulluar ose prerë ato, duke i ndarë ato me shokët, duke i cilësuar ato si foto kontakti ose si sfond, etj.

Gjej vendndodhjen e fotos me të cilën dëshiron të punosh dhe prek foton në pamjen e fotos në ekranin e plotë. Prek ikonën për të ndarë foton, ose prek ikonën për të redaktuar foton. Prek dhe zgjidh **Vendos si...** për të vendosur foton si foto Kontakti ose Sfond.




Prek në pamjen me ekranit të plotë për të modifikuar foton përmes **Editorit (E parazgjedhur)** ose **Editorit të Polaroid**.



### Editori (E parazgjedhur)




Vendos efekte të tilla si **Grushtim, I qëmotshëm, Bardh e zi, Zbardhues,** etj.

Shto një kornizë.

**Prit, Drejto, Rrotullo, Pasqyro** ose **Vizato** fotografinë.

Rregullo ngjyrën e fotos.

### Veprimi në grup

Galeria siguron një funksion zgjedhje të shumëfishtë, mund të punosh me fotot/videot në grupe.

Te ekrani **MOMENTET** ose **ALBUMET**, prek dhe më pas **Zgjidh artikullin** për të aktivizuar regjimin e veprimit në grup (mund të shtypësh gjithashtu gjatë një album/fotografi), më pas prek videot/fotot me të cilat dëshiron të punosh. Prek për të ndarë ose prë të fshirë artikujt e zgjedhur.

## 7.3 Muzika ............................................................

Mund të luash skedarët muzikorë të ruajtur në telefon ose kartën microSD. Skedarët muzikorë mund të shkarkohen nga kompjuteri në telefon ose kartën microSD duke përdorur një kabllo USB.

Për të luajtur muzikë, prek **Muzika** nga ekrani Kryesor.

Do të gjesh katër kategori në të cilat gjithë këngët janë klasifikuar: **Artistët, Albumet, Këngët** dhe **Listat e këngëve**. Prek skedat e tyre për të hapur listat.

### 7.3.1 Për të luajtur muzikë

Prek një këngë për ta luajtur atë.




1. Kthehu tek ekrani i mëparshëm.
2. Kërko muzikë në telefonin tënd ose në kartën microSD.
3. Hap menynë e opsioneve.
4. Hap listën e këngëve.
5. Prek për të aktivizuar ose çaktivizuar regjimin e përzierjes.
6. Prek ikonën për të zgjedhur një regjim përsëritjeje: **Përsërit të gjitha këngët, Përsërit këngën aktuale, Përsëritja joaktive**.
7. Zvarrit kokën e leximit për të kapërcyer te ndonjë pjesë e një kënge.
8. Kthehu te kënga e mëparshme.
9. Luaj/vendos në pauzë.
10. Kapërce te kënga e radhës.

Ndërsa luan këngët me Muzikën mund të bësh Pauzë, Luash ose Kapërcesh muzikën edhe nëse ekrani është i kyçur.



# 8 Të tjerat......................................

## 8.1 Menaxheri i skedarëve....................................

Për të menaxhuar skedarët në telefon, prek skedën Aplikacioni nga ekrani Kryesor, më pas zgjidh **Menaxheri i skedarëve**.

**Menaxheri i skedarëve** punon me kartën e jashtme SD dhe hapësirën e ruajtjes në telefon.

**Menaxheri i skedarit** shfaq të gjitha të dhënat e ruajtura në dyja kartat, atë microSD dhe të hapësirës ruajtëse të telefonit, përfshirë aplikacionet, skedarët media; videot, fotot ose audiot që ke regjistruar; të dhëna të tjera që ke transferuar nëpërmjet Bluetooth, fishës USB, etj.

Kur shkarkon një aplikacion nga PC te telefoni, mund ta vendosësh aplikacionin në Menaxherin e skedarëve, pastaj preke për ta instaluar atë në telefon.

**Menaxheri i skedarëve** të lejon të kryesh dhe te jesh me të vërtetë efikas me veprimet e zakonshme të mëposhtme: krijo (nën) dosje, hap dosje/skedë, shiko, riemëro, lëviz, kopjo, fshij, luaj, ndaj, etj.

## 8.2 Regjistruesi i zërit..........................................

Për të regjistruar një tingull ose memo zanore, prek skedën e Aplikacionit nga ekrani Kryesor, pastaj zgjidh **Regjistruesi i zërit**.

**Regjistruesi i zërit** të lejon të regjistrosh zë ose tingull për sekonda/orë.

## 8.3 Radio ..........................................................

Telefoni është i pajisur me një radio [1] me funksion RDS[2]. Mund ta përdorësh këtë aplikacion si një radio tradicionale me kanale të ruajtura ose me informacione vizuale paralele të lidhura me programin e radios në ekran nëse e sintonizon në stacione që ofrojnë shërbim Visual Radio.

Për të dëgjuar radion, prek skedën e Aplikacionit nga ekrani Kryesor, pastaj zgjidh **Radio**.

Fut një kufje për të dëgjuar radion. Kufja përdoret si një antenë për radion.




(1) Cilësia e radios varet nga mbulimi me valë i stacionit të radios në atë zonë të caktuar.
(2) Në varësi të operatorit të rrjetit dhe tregut.



**Opsionet e mundshme:**

- **Skano kanalet** Skano për të gjitha kanalet e disponueshme.
- **Modifiko emrin** Modifiko emrin e kanalit.
- **Fshi** Fshi kanalin aktual
- **Fut frekuencën** Fute frekuencën manualisht për t'u sintonizuar në kanal.
- **Informacioni i kanalit** Shëno kutinë e kontrollit për të afishuar informacionin e stacionit.
- **Dil** Fik radion.

## 8.4 Onetouch Launcher [1] ..................................

Onetouch Launcher mbështet njoftimet e palexuara nga telefonatat në **Telefon**, **Mesazhet, Kalendari,** etj. por kërkon në fillim lejet e aplikacionit.

Te asistenti i konfigurimit kur konfiguron në fillim telefonin, prek butonin **Lejo** te dritaret që hapen në ekranin **Onetouch Launcher**. Ose shko te **Cilësimet > Aplikacionet > Onetouch Launcher > Lejet**, aktivizo ato çelësa për të lejuar lejet e qasjes, ose prek ⋮ dhe më pas **Të gjitha lejet** për detaje.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F)
PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).

## 8.5 Qendra e përdoruesit [1] ..................................

Me një llogari OneTouch, mund të përdorësh **Qendrën e përdoruesit** për të marrë pothuajse të gjitha shërbimet dhe mbështetjet që ke nevojë, duke përfshirë konsultimin e PESh, shkarkimin e manualit të përdorimit, ruajtjen e përmbajtjes në re kompjuterike, etj.

Fut emrin e llogarisë dhe fjalëkalimin për t'u identifikuar. Nëse nuk ke një llogari, prek **Regjistrohu** dhe ndiq udhëzimet në ekran për të krijuar një të tillë.

## 8.6 Kujdesi për përdoruesin................................

**Kujdesi për përdoruesin** të ndihmon të mësosh më shumë rreth PESh, udhëzimeve të përdorimit, zgjidhjes së problemeve, etj. Gjithashtu mund të japësh përshtypje rreth komenteve të tua përmes saj.

## 8.7 Smart Suite ..................................................

Smart Suite të ndihmon të menaxhosh pajisjen Android nga PC me një lidhje USB ose Wi-Fi.

- **Kontaktet**

  Mundëson rezervimin e kontakteve, në mënyrë që të mos shqetësohesh për humbjen, thyerjen, ndërrimin e telefonave ose ndërrimin e ofruesve të shërbimit.

- **Mesazhet**

  Ju liron nga shkrimi i tekstit me kujdes në tastierë. Të gjitha mesazhet e tua mund të hapen lehtësisht dhe janë të mirë-organizuara.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F)
PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).



- **Kalendari**

  Mundëson sinkronizimin e lehtë të ngjarjeve ndërmjet telefonit dhe "Outlook" dhe krijimin dhe modifikimin e ngjarjeve të reja nga kompjuteri.

- **Fotot**

  Mundëson importimin e thjeshtë të fotove nga kompjuteri ose pajisja portative dhe organizimin e tyre në albume të ndryshme për menaxhim më të mirë.

- **Videot**

  Mundëson futjen e skedarëve video nga kompjuteri për luajtje dhe më pas ngarkimin e tyre në një dosje të pajisjes portative.

- **Muzika**

  Të lejon të kërkosh shpejt për të preferuarat në kompjuter, të menaxhosh Bibliotekën më të mirë dhe të shijosh xhukboksin muzikor më të lehtë dixhital gjatë kohës që je në lëvizje.

- **Aplikacionet**

  Mundëson importimin e aplikacioneve të shkarkuara celular dhe instalimin e tyre në pajisjen portative gjatë sinkronizimit.

- **Rezervimi**

  Mundëson rezervimin e kontakteve, mesazheve, kalendarit, fotove dhe aplikacioneve, dhe më pas importimin e skedarëve të rezervimit në telefonin tuaj.

**Sistem i mbështetur operativ**

Windows XP/Vista/Windows 7/Windows 8.

# 9 Aplikacionet e Google [1] ...........

Aplikacionet e Google janë të parainstaluara në telefon për të përmirësuar efikasitetin tënd në punë dhe për të të ndihmuar të shijosh jetën.

Ky manual i përshkruan shkurtimisht aplikacionet. Për funksionet e detajuara dhe udhëzimet e përdorimit, referoju sajteve përkatëse të uebit ose prezantimit që jepet në aplikacione.

Rekomandojmë që të regjistrohesh me një llogari të Google për të përfituar të gjitha funksionet.

## 9.1 Play Store

Shërben si dyqani zyrtar i aplikacioneve për sistemin operativ Android, duke u lejuar përdoruesve të shfletojnë dhe shkarkojnë aplikacione dhe lojëra. Aplikacionet janë falas ose me pagesë.

Në Play Store, kërko aplikacionin që të nevojitet, shkarkoje dhe më pas ndiq udhëzuesin e instalimit për ta instaluar aplikacionin. Gjithashtu mund të çinstalosh, përditësosh një aplikacion dhe menaxhosh shkarkimet e tua.

## 9.2 Chrome

Duke përdorur shfletuesin Chrome mund të lundrosh në ueb. Faqeshënuesit, historiku i shfletimit dhe cilësimet në të gjitha pajisjet me shfletuesin e instaluar mund të sinkronizohen me llogarinë e Google.

Për të hyrë në ueb, shko tek ekrani kryesor dhe prek ikonën Chrome në shiritin të Preferuara.

**Kalimi në një faqe interneti**

Në ekranin e shfletuesit Chrome, prek kutinë e URL lart, fut adresën e faqes ueb, pastaj prek për të konfirmuar.

[1] Disponueshmëria varet nga variantet e telefonit.






Gjatë lundrimit në ueb, prek ⋮ për cilësimet ose më shumë opsione.

## 9.3 Gmail

Si shërbim emaili bazuar në ueb i Google, Gmail konfigurohet kur konfiguron fillimisht telefonin. Gmail në telefon mund të sinkronizohet automatikisht me llogarinë tënde të Gmail në ueb. Me këtë aplikacion, mund të marrësh dhe dërgosh emaile, mund të menaxhosh lista sipas etiketave dhe të arkivosh emaile, etj.

**Për të hapur Gmail**

Nga ekrani Kryesor, prek ikonën e **Gmail** në shiritin Të preferuarat.

Gmail shfaq mesazhe dhe biseda nga një llogari e vetme e Gmail-it njëkohësisht. Nëse zotëron më shumë se një llogari, mund të shtosh një llogari duke prekur ikonën dhe më pas pas emrit të llogarisë nga ekrani Kutia hyrëse, më pas prek **Shto llogari**. Kur të përfundosh, mund të kalosh në një llogari tjetër duke prekur emrin e llogarisë që dëshiron të shfaqësh.

**Krijimi dhe dërgimi i emaileve**

1 Prek nga ekrani i Kutisë hyrëse.

2 Fut adresën e emailit të marrësit në fushën **Për**.

3 Nëse është e nevojshme, prek ikonën e menysë **Shto Cc/Bcc** për të shtuar një kopje ose një kopje të verbër te mesazhi.

4 Vendos subjektin dhe përmbajtjen e mesazhit.

5 Prek ikonën dhe zgjidh **Bashkëngjit skedar** për të shtuar një bashkëngjitje.

6 Në fund, prek ikonën për ta dërguar.

7 Nëse nuk do ta dërgosh emailin menjëherë, mund të prekësh ikonën dhe pastaj **Ruaj skicën** ose prek tastin **Prapa** për të ruajtur një kopje. Për të shfaqur skicën, prek emrin e llogarisë për të shfaqur gjithë emërtimet, pastaj zgjidh **Skica**.

Nëse nuk dëshiron të dërgosh ose ruash emailin, mund të prekësh ikonën dhe pastaj prek **Hidh**.

Për të shtuar një nënshkrim te emailet, prek ikonën dhe pastaj prek

**Cilësimet** nga ekrani i Kutisë hyrëse, zgjidh një llogari dhe pastaj prek **Nënshkrimi**.

**Për të marrë dhe lexuar emailet**

Kur vjen një email i ri, do të njoftohesh nga një zile ose vibrim, dhe një ikonë do të shfaqet në shiritin e Statusit.

Zvarrit poshtë shiritin e statusit për të shfaqur panelin e Njoftimeve, prek emailin e ri për ta hapur atë. Ose gjithashtu mund të hapësh etiketën Kutia marrëse e Gmail dhe prek mesazhin e ri për ta lexuar atë.

Mund të kërkosh një email sipas dërguesit, marrësit, subjektit, etj.

1 Prek ikonën nga ekrani i Kutisë hyrëse.

2 Fut fjalën kyç që dëshiron të kërkosh në kutinë e kërkimit dhe prek në tastierën e softuerit.

**Për të kthyer përgjigje ose transferuar emailet**

| | |
|---|---|
| • **Përgjigju** | Kur shfaq një email, prek për t'iu përgjigjur. |
| • **Përgjigju të gjithëve** | Prek dhe zgjidh **Përgjigju të gjithëve** për të dërguar mesazh te të gjithë personat në një zinxhir emaili. |
| • **Transfero** | Prek dhe zgjidh **Transfero** për t'ua përcjellë mesazhin e marrë njerëzve të tjerë. |



## 9.4 Hartat

Google Maps ofron imazheri satelitore, harta të rrugëve, pamje panoramike 360° të rrugëve, kushtet e trafikut në kohë reale, si dhe planifikime të itinerareve për të udhëtuar më këmbë, me makinë apo transport publik. Duke përdorur këtë aplikacion, mund të gjesh vendndodhjen tënde, mund të kërkosh një vend dhe të marrësh planifikime të sugjeruara të itinerareve për udhëtimet e tua.

## 9.5 YouTube

YouTube është një aplikacion online për ndarjen e videove ku përdoruesit mund të ngarkojnë, shohin dhe ndajnë video. Përmbajtja e disponueshme përmban klipe video, video muzikore dhe përmbajtje të tjera siç janë blogjet me video, video origjinale të shkurtra dhe video edukative. Ajo mbështet një funksion transmetimi që të lejon të fillosh të shohësh video pothuajse menjëherë sapo fillojnë të shkarkohen nga interneti.

## 9.6 Drive

Një hapësirë ruajtje për skedarë dhe shërbim sinkronizimi i krijuar nga Google, që u lejon përdoruesve të ruajnë skedarë në re kompjuterike, të ndajnë dhe të redaktojnë skedarë.

Skedarët te Drive ruhen mirë dhe mund të arrish te skedarët e tu nga çdo pajisje e jotja duke u identifikuar në llogarinë tënde të Google. Skedarët ose dosjet mund të ndahen privatisht me përdorues të caktuar që kanë një llogari Google.

## 9.7 Play Music

Një shërbim transmetimi muzikor dhe arkiv online i muzikës i operuar nga Google.

Mund të ngarkosh dhe dëgjosh një numër të madh këngësh falas. Përveç ofrimit të transmetimit muzikor për pajisjet e lidhura me internetin, aplikacioni Google Play Music lejon që muzika të ruhet dhe të dëgjohet jashtë linje. Këngët e blera përmes Play Music shtohen automatikisht në llogarinë e përdoruesit.

## 9.8 Play Movies & TV

Filmat dhe programet televizive mund të shikohen online përmes Google Play Movies & TV. Gjithashtu mund të shkarkosh filma dhe programe televizive për t'i parë jashtë linje. Disa përmbajtje janë të disponueshme vetëm për marrje me qira ose blerje.

## 9.9 Hangouts

Google Hangouts është një platformë komunikimi e zhvilluar nga Google e cila përfshin funksione për mesazhe të çastit, biseda video, SMS dhe VOIP. Duhet të shtosh një shok dhe më pas mund të fillosh të bisedosh. Të gjithë shokët e shtuar përmes Hangouts nga uebi apo pajisja do të shfaqen në listën e shokëve.

## 9.10 Fotot

Google Photos ruan dhe rezervon fotot dhe videot e tua. Ai analizon gjithashtu automatikisht fotot dhe i organizon ato në grupe, në mënyrë që të mund t'i lokalizosh me shpejtësi fotot që ke nevojë.

## 9.11 Keep

Një aplikacion për mbajtjen e shënimeve i zhvilluar nga Google.

Mund të fusësh imazhe, lista dhe të regjistrosh zëra në shënimet e tua dhe të caktosh kujtesa për shënimet sipas kohës dhe vendit. Google Keep të lejon të kategorizosh shënimet sipas etiketave dhe shënimet mund të kërkohen bazuar në ngjyrën e tyre, qoftë kur kanë kujtesa, audio, imazhe apo janë lista.

## 9.12 Translate

Një shërbim falas i automatizuar statistikor mes shumë gjuhësh i ofruar nga Google për të përkthyer tekst, të folur, imazhe apo video në kohë reale nga njëra gjuhë në tjetrën.

Ofron ndërfaqe celulare për Android në mënyrë që të mund ta përdorësh për të përkthyer në çast tekstin e printuar apo për të diktuar automatikisht gjuhët e folura.



# 10 Cilësimet..............................

Për të shkuar te **Cilësimet**, prek skedën e Aplikacionit nga ekrani Kryesor, më pas zgjidh **Cilësimet**.

## 10.1 Me valë dhe rrjetet

### 10.1.1 Wi-Fi

Gjatë përdorimit të Wi-Fi mund të lundrosh në internet pa përdorur kartë SIM kurdo që je brenda rrezes së një rrjeti me valë. E vetmja gjë që duhet të bësh është të hysh në ekranin **Wi-Fi** dhe të konfigurosh një pikë hyrjeje për të lidhur telefonin tënd me rrjetin me valë.

Për udhëzime të detajuara rreth përdorimit të Wi-Fi, referohu te "**6.1.2 Wi-Fi**".

### 10.1.2 Bluetooth

Bluetooth lejon telefonin që të shkëmbejë të dhëna (video, imazhe, muzikë, etj.) në një zonë të vogël me një tjetër aparat që mbështet Bluetooth (telefon, kompjuter, printer, kufje, set makine, etj.).

Për më shumë informacion mbi Bluetooth, referoju "6.2 Lidhja me pajisjet Bluetooth".

### 10.1.3 Kartat SIM

Menaxho kartat SIM për lidhjen e të dhënave celulare, kryerjen e thirrjeve dhe dërgimin e mesazheve SMS.

### 10.1.4 Cilësimet e thirrjes [1]

Shëno kutinë e kontrollit për të aktivizuar **Reduktimin e zhurmës** gjatë thirrjeve dhe **Kujtuesin e dridhjeve** kur thirrjet dalëse lidhen me sukses [2]. Mund të zgjedhësh gjithashtu një kartë SIM për më shumë cilësime thirrjeje. (Shko te **"3.1.6 Cilësimet e thirrjes"** për më shumë detaje.)

### 10.1.5 Përdorimi i të dhënave

**Të dhënat celulare**

Për të aktivizuar/çaktivizuar të dhënat celulare duke prekur çelësin .

Nëse nuk e ke të nevojshme të transmetosh të dhëna në rrjetet celulare, çaktivizo **Të dhënat të aktivizuara** për të shmangur tarifime të konsiderueshme për përdorimin e të dhënave në rrjetet lokale të operatorëve celularë, sidomos nëse nuk ke një paketë të dhënash celulare.

**Vendos limitin e të dhënave celulare**

Prek çelësin  për të aktivizuar limitin e të dhënave celulare. Më pas pastaj zvarrit limitin dhe vijat paralajmëruese për të konfiguruar maksimumin e të dhënave celulare që dëshiron të përdorësh.

Duke aktivizuar **Vendos limitin e të dhënave celulare**, lidhja e të dhënave celulare do të çaktivizuar kur të arrihet limiti i specifikuar. Gjithashtu mund të zgjedhësh një cikël përdorimi të dhënash për të parë statistikat dhe aplikacionet e lidhura me përdorimin e të dhënave nga telefoni.

Prek ⋮ dhe mund të shfaqësh më shumë cilësime lidhur më përdorimin e të dhënave.

Përdorimi i të dhënave matet nga telefoni dhe operatori mund ta llogarisë ndryshe.

### 10.1.6 Më shumë\Regjimi i fluturimit

Aktivizo çelësin **Regjimi i fluturimit**  për të çaktivizuar njëherësh të gjitha lidhjet me valë duke përfshirë Wi-Fi, Bluetooth dhe më shumë.

(1) E disponueshme vetëm me një kartë SIM të futur.
(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).



Gjithashtu mund të zgjedhësh **Regjimin e fluturimit** në opsionet e telefonit kur të shtypësh tastin e **Energjisë**.

### 10.1.7 Më shumë > Aplikacioni SMS [1]

Zgjidh aplikacionin e parazgjedhur për funksionet SMS.

### 10.1.8 Më shumë\Ndarja dhe pika shpërndarëse e lëvizshme

Ky funksion të lejon të ndash lidhjen e të dhënave celulare nëpërmjet USB ose si një pikë hyrjeje e lëvizshme Wi-Fi (referoju "6.4 Ndarja e lidhjes së të të dhënave celulare").

### 10.1.9 Më shumë\VPN

Një rrjet virtual privat celular (VPN ose mVPN celulare) u siguron pajisjeve celulare qasje në burimet e rrjetit dhe aplikacionet softuere në rrjetin e tyre kryesor, kur ato lidhen nëpërmjet një tjetër rrjeti me valë ose me tela. VPN celulare përdoren në mjedise ku punonjësit kanë nevojë të mbajnë sesionet e aplikacioneve të tyre hapur gjithë kohës, gjatë ditës së punës, ndërkohë që përdoruesi lidhet nëpërmjet rrjeteve të ndryshme pa tela, has boshllëqe në mbulim ose pezullon dhe rinis pajisjet e tij për të ruajtur jetën e baterisë. Një VPN konvencionale nuk mund t'u mbijetojë ngjarjeve të tilla sepse tuneli i rrjetit ndërpritet, duke bërë që aplikacionet të shkëputen, vonohen, dështojnë, madje edhe vetë pajisja kompjuterike të mos punojë.

Për më shumë informacion për VPN, shko te "6.5 Lidhja me rrjetet private virtuale".

### 10.1.10 Më shumë\Rrjetet celulare

**Roaming i të dhënave**

Aktivizo çelësin  për të aktivizuar lidhjen e të dhënave gjatë kohës që je në roaming.

Nëse nuk të nevojiten shërbimet e të dhënave gjatë kohës që je në roaming, çaktivizo **Roaming i të dhënave** për të shmangur tarifime të konsiderueshme në roaming.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F)
PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U).

**Rrjetet e preferuara**

Prek për të përzgjedhur e preferuar celular.

**Llojet e preferuara të rrjetit**

Vendos llojet e preferuara të rrjetit në **UMTS/GSM (automatike), Vetëm UMTS,** ose **Vetëm GSM** (1) ose **4G, 3G** ose **2G** (2).

**Regjimi i përmirësimit 4G LTE** (2)

Cilësia e komunikimit do të përmirësohet me **Regjimin e përmirësimit 4G LTE** të aktivizuar si parazgjedhje. Nëse ke nevojë ta çaktivizosh funksionin, çaktivizo çelësin .

**Emrat e pikës së hyrjes**

Mund të zgjedhësh rrjetin e preferuar APN me këtë meny.

**Operatorët e rrjetit**

Mund të zgjedhësh një operator rrjeti.

## 10.2 Pajisja

### 10.2.1 Funksioni

Shko te **Cilësimet** > **Kyç cilësimet** (1) **> Funksioni** për të hapur **Funksionin** dhe kontrollo shkurtoret e aplikacionit të afishuara në ekranin e kyçjes.

Me **Funksionin** të aktivizuar, mund të heqësh një shkurtore aplikacioni nga afishimi në ekranin e kyçjes duke prekur pas saj ose shto një duke prekur + (1).

Çaktivizo çelësin për të çaktivizuar Funksionin nëse nevojitet.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F) PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U).
(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).



### 10.2.2 Gjestet

Gjestet e mëposhtme mund të përdoren për operacionet e shpejta:

- **Kthe përmbys për ta heshtur** Shëno kutinë e kontrollit për të vendosur në heshtje thirrjet hyrëse duke kthyer përmbys telefonin.
- **Kthe përmbys për ta refuzuar** (1) Shëno kutinë e kontrollit për të refuzuar thirrjet hyrëse duke kthyer përmbys telefonin.
- **Kthe përmbys për ta aktivizuar** Aktivizo çelësin dhe më pas zgjidh një sjellje të kthimit përmbys për **Dremitur** ose **Larguar** një alarm hyrëse.

### 10.2.3 Ekrani

Në këtë meny, mund të personalizosh ndriçimin e ekranit, sfondin, kohën e fjetjes së telefonit, madhësinë e fontit, etj.

Nëse dëshiron të rrotullosh përmbajtjen e ekranit kur rrotullon pajisjen: shëno kutinë e kontrollit të **Rrotullo automatikisht ekranin** (1) ose prek **Kur pajisja rrotullohet > Rrotullo përmbajtjen e ekranit** (2).

Mund të heqësh gjithashtu shënimin e kutisë së kontrollit të **Ekranit të operatorit të rrjetit** për të fshehur emrin e rrjetit në shiritin e statusit (1).

### 10.2.4 Drita e njoftimit (1)

Drita e njoftimit do të jetë e ndezur si parazgjedhur kur bateria është më e ulët se 15% dhe kur ka një thirrje të humbur, një mesazh hyrës apo email, etj. Për ta çaktivizuar, hiq shënimin e kutive të kontrollit.

### 10.2.5 Cilësimet e kyçjes (1)

**Funksioni**

Shiko detajet te "**10.2.1 Funksioni**".

**Kyçja e ekranit/Mesazhi i kyçjes së ekranit** (1) ose **Informacioni i zotëruesit** (2)**/Kyçja inteligjente**

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F) PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U).
(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).

Shko te **Cilësimet > Cilësimet e kyçjes** [1] ose **Siguria** [2] për të hapur cilësimet e sigurisë së ekranit.

Prek **Kyçja e ekranit** dhe zgjidh një mënyrë shkyçjeje të ekranit dhe më pas ndiq udhëzimet në ekran për të përfunduar cilësimet e kyçjes së ekranit. Më shumë cilësime, **Bëje motivin të dukshëm**, **Kyç automatikisht** dhe **Butoni i Energjisë kyç në çast**, do të jenë të disponueshme nëse kyç telefonin me një Motiv, PIN, fjalëkalim.

Prek **Mesazhi i ekranit të kyçjes** [1] ose **Informacioni i zotëruesit** [2] për të futur tekst ose informacionin e zotëruesit të shfaqur në ekranin e kyçjes.

Me **Kyçjen inteligjente**, mund të vendosësh pajisjet e besuara, vendet, fytyrat, zërin, etj. Duhet të vendosësh fillimisht një kyçje të ekranit kur aktivizon këtë funksion.

### 10.2.6 Tingulli dhe njoftimet

Përdor cilësimet e Tingullit për të konfiguruar zilet për ngjarje dhe mjedise të ndryshme.

- **Tingulli** Rrëshqit për të rregulluar volumin për median, alarmin, zilen, etj.
- **Regjimi i kufjeve** Shëno kutinë e verifikimit për të mundësuar regjimin e kufjeve. Zilet do të dëgjohen vetëm nga kufjet nëse janë të lidhura.
- **Edhe dridhje për thirrje** Aktivizo çelësin për të dridhur telefonin nga thirrjet hyrëse.
- **Mos shqetëso** Prek për të vendosur se si thirrjet dhe njoftimet ndërpresin çdo gjë që je duke bërë me telefonin.
- **Zilja e telefonit** Prek për të vendosur zilen e thirrjes hyrëse.
- **Zilja e paracaktuar e njoftimit** Prek për të vendosur zilen e paracaktuar të njoftimeve.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F) PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U).
(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).



- **Zilja e ndezjes/fikjes** Çaktivizo çelësin pas **Vendos në heshtje zilen e ndezjes/fikjes** [1] ose shëno kutinë e kontrollit të **Zilja e ndezjes/fikjes** [2] për të aktivizuar zilen kur fik ose ndez telefonin.
- **Tinguj të tjerë** Prek te çelësat për të aktivizuar tonet e tastierës së numrave, tingujt e kyçjes së ekranit, tingujt e prekjes dhe dridhjen gjatë prekjes. Mund të vendosësh këtu gjithashtu **Kohëzgjatjen e dridhjes së reagimit të prekjes** këtu [2].
- **Kur pajisja është e kyçur** Prek për të zgjedhur se kur të shfaqet e gjithë përmbajtja e njoftimeve ose të mos shfaqen fare njoftimet kur pajisja është e kyçur.
- **Njoftimet e aplikacioneve** Prek për të bllokuar, vendosur prioritetin, ose për të lejuar shikimin e shpejtë për njoftime nga aplikacionet.
- **Qasja e njoftimeve** Prek për të shfaqur dëgjuesit e njoftimit.
- **Qasja në Mos shqetëso** Prek për të shfaqur aplikacionet e instaluara të cilat kanë kërkuar qasje në **Mos shqetëso**.

### 10.2.7 Aplikacionet

Cilësimet e aplikacioneve i përdor për të shfaqur detajet në lidhje me aplikacionet e instaluara në telefon, për të menaxhuar të dhënat e tyre dhe për t'i detyruar ato të ndalojnë, për të vendosur nëse dëshiron të lejosh instalimin e aplikacioneve që merr nga faqet e internetit dhe emailet, etj.

### 10.2.8 Hapësira ruajtëse dhe USB

Përdor këto cilësime për të monitoruar hapësirën totale dhe të disponueshme në telefon dhe në kartën microSD; si dhe për të menaxhuar kartën microSD.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F) PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U).
(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).

### 10.2.9 Bateria

Në ekranin Bateria mund të zgjedhësh nëse do të shfaqet përqindja e baterisë në shiritin e statusit ose për të aktivizuar kursimin inteligjent të energjisë.

Gjithashtu mund të shohësh të dhënat e përdorimit të baterisë që prej karikimit të fundit të plotë. Ekrani gjithashtu tregon statusin e baterisë dhe sa gjatë mund të përdoret përpara karikimit tjetër. Prek një kategori, pastaj mund të mësosh konsumin e saj specifik të energjisë.

Mund të rregullosh përdorimin e energjisë nëpërmjet dritës së ekranit ose vonesës së ekranit në cilësimet e **Ekranit**.

### 10.2.10 Memoria

Hape këtë cilësim për të monitoruar memorien totale, hapësirën e disponueshme dhe të dhënat e përdorimit të memories.

## 10.3 Personale

### 10.3.1 Vendndodhja

Aktivizo çelësin për të aktivizuar informacionin e vendndodhjes nga Wi-Fi dhe rrjetet celulare, përdorimin e Google Maps, etj.

**Regjimi**

Zgjidh një regjim për qasjen e vendndodhjes.

- **Saktësia e lartë**: Përdor GPS, Wi-Fi dhe rrjetet celulare për të përcaktuar vendndodhjen.
- **Kursimi i baterisë**: Përdor Wi-Fi, Bluetooth dhe rrjetet celulare për të përcaktuar vendndodhjen.
- **Vetëm pajisja:** Përdor GPS për të përcaktuar vendndodhjen.

**Kërkesë e fundit për vendndodhjen**

Kjo listë tregon aplikacionet që kanë kërkuar vendndodhjen së fundi.



### 10.3.2 Siguria

**Kyçja e ekranit/Informacioni i zotëruesit/Kyçja inteligjente** [(1)]

Shiko detajet te "**10.2.5 Cilësimet e kyçjes**".

**Enkripto telefonin** [(2)]

Kërkon një PIN numerik, motiv ose fjalëkalim për të deshifruar telefonin sa herë që e ndez.

**Gjej telefonin tim**

Aktivizo çelësin për të mbrojtur privatësinë tënde në rast vjedhjeje ose humbjeje.

**Konfiguro kyçjen e kartës SIM**

Zgjidh një kartë SIM që dëshiron ta konfigurosh nëse telefoni ka dy karta.

Aktivizo çelësin **Kyç kartën SIM** për të kyçur kartën SIM me kod PIN.

Prek **Ndrysho SIM PIN** për të ndryshuar kodin PIN.

**Bëji fjalëkalimet të dukshme**

Aktivizo çelësin për të treguar fjalëkalimet ndërsa i shkruan.

**Administratorët e pajisjes**

Prek për të parë ose çaktivizuar administratorët e pajisjes.

**Burime të panjohura**

Hap çelësin për të lejuar instalimin e aplikacioneve që merr nga uebsajtet, emailet apo vende të tjera ndryshe nga Google Play Store.

Për të mbrojtur telefonin dhe të dhënat personale, shkarko aplikacione vetëm nga burime të besuara, të tilla si Google Play Store.

(1) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).
(2) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D, 5010X, 5010D, 5010U).

**Menaxhimi i nisjes automatike** [(1)]

Menaxho aplikacionet që nisen automatikisht kur ndizet sistemi.

**Lejet e aplikacionit** [(1)]

Aktivizo çelësin për të menaxhuar lejet e aplikacionit për mbrojtjen e sigurisë dhe të privatësisë.

**Lloji i hapësirës ruajtëse**

Lloji i hapësirës ruajtëse është vendosur në **Vetëm softuer** si parazgjedhje.

**Kredenciale të besuara**

Prek për të shfaqur certifikatat e besuara CA.

**Instalo nga memoria** [(2)]**/hapësira e brendshme ruajtëse** [(3)]

Prek për të instaluar certifikatat nga **memoria** [(2)] ose **hapësira e brendshme ruajtëse** [(3)].

**Pastro kredencialet**

Prek për të hequr të gjitha certifikatat.

**Agjentët e besuar**

Hap cilësimin për të parë dhe çaktivizuar agjentët e besuar. Duhet të vendosësh fillimisht një kyçje ekrani kur aktivizon këtë funksion.

**Gozhdimi i ekranit**

Hap çelësin , mund ta mbash gjithmonë një ekran në pamje derisa ta heqësh atë. Hap ekranin që dëshiron të gozhdosh, prek tastin **Pamje e përgjithshme**, rrëshqit lart ekranin dhe më pas prek ikonën e gozhdimit . Për ta hequr, shtyp gjatë tastin **Prapa**.

(1) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F).
(2) Vetëm PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F)
PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U).
(3) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).



**Aplikacion me qasje në përdorim**

Hap menynë për të parë ose rivendosur qasjen e përdorimit të aplikacionit.

### 10.3.3 Llogaritë

Përdor cilësimet për të shtuar, hequr dhe menaxhuar emailin dhe llogari të tjera mbështetëse. Gjithashtu mund të përdorësh këto cilësime për të kontrolluar si dhe nëse të gjithë aplikacionet dërgojnë, marrin dhe sinkronizojnë të dhënat në programet e tyre dhe nëse të gjitha aplikacionet mund të sinkronizojnë automatikisht të dhënat e përdoruesve të tyre..

**Shto llogari**

Prek ikonën + te **Shto llogari** për të shtuar një llogari për aplikacionin e zgjedhur.

### 10.3.4 Google

Ky telefon ofron llogari Google dhe opsionet e cilësimeve të shërbimeve.

### 10.3.5 Gjuha dhe hyrja

Përdor cilësimet Gjuha dhe futja e të dhënave për të zgjedhur gjuhën për tekstin në telefon dhe për konfigurim të tastierës virtuale. Gjithashtu mund të konfigurosh cilësime të futjes së zërit dhe të shpejtësisë së treguesit.

**Gjuha**

Zgjidh gjuhën dhe rajonin që dëshiron.

**Kontrolli drejtshkrimor**

Hap çelësin për të mundësuar sistemin të shfaqë fjalët e sugjeruara.

**Fjalori personal**

Hap listën e fjalëve që ke shtuar në fjalor. Prek një fjalë për ta redaktuar ose fshirë atë. Prek butonin e shtimit + për të shtuar një fjalë.

**Tastiera aktuale**

Zgjidh një metodë të paracaktuar futje të dhënash.

### Tastiera Android (AOSP)

Hap menytë për të vendosur gjuhën e Android, preferencat e shkrimit, pamjen dhe strukturën, shkrimin me gjeste, korrigjimin e shkrimit, etj.

### Shtypja me zë e Google

Prek kreun e menysë dhe përfundo cilësimet e shtypjes me zë të Google në ekranin që shfaqet.

### Cilësimet e tekstit në të folur

- **Motori i preferuar:** Zgjidh një motor të preferuar të konvertimit nga teksti në të folur, prek ikonën e cilësimeve ⚙ për të shfaqur më shumë alternativa për çdo motor.
- **Shpejtësia e të folurit:** Prek për të hapur një dialog ku mund të zgjedhësh se sa shpejt dëshiron që sintetizuesi të flasë.
- **Dëgjo një shembull:** Prek që të luash një shembull të shkurtër të instrumentit të fjalimit, duke përdorur cilësimet e tua aktuale.
- **Statusi i paracaktuar i gjuhës:** Kjo do të tregojë statusin e gjuhës së paracaktuar.

### Shpejtësia e kursorit

Prek për të hapur një dialog ku mund të ndryshosh shpejtësinë e kursorit, prek **Në rregull** për të konfirmuar.

## 10.3.6 Rezervimi i të dhënave dhe rivendosja

### Krijo kopje rezervë të të dhënave

Hap çelësin për të ruajtur cilësimet e telefonit dhe të dhëna të tjera të aplikacioneve në serverët e Google, me llogarinë tënde të Google. Nëse zëvendëson telefonin, cilësimet dhe të dhënat që ke ruajtur do të restaurohen në telefonin e ri herën e parë që identifikohesh në llogarinë tënde të Google. Kur aktivizon këtë funksion, ruhet një variacion i gjerë i cilësimeve dhe të dhënave, duke përfshirë fjalëkalimet Wi-Fi, faqeshënuesit, një listë e aplikacioneve që ke instaluar, fjalët që ke shtuar në fjalor duke përdorur tastierën virtuale, si dhe shumicën e cilësimeve që konfiguron me aplikacionin Cilësimet. Nëse e çaktivizon këtë opsion, do të ndalosh ruajtjen e cilësimeve të tua dhe çdo rezervim ekzistues fshihet nga serverët e Google.



### Rezervimi i llogarisë

Shfaq llogarinë e rezervimit, mund të shtosh një të tillë duke prekur ikonën **Shto llogari** +.

### Restaurimi automatik

Hap çelësin për restauruar cilësimet e rezervuara ose të dhëna të tjera kur riinstalon një aplikacion.

### Rivendosja e cilësimeve të rrjetit

Prek butonin RIVENDOSNI CILËSIMET për të rivendosur të gjitha cilësimet e rrjetit.

### Rivendosja DRM

Ky operacion do të fshijë të gjitha licencat në pajisje.

### Rivendosja e të dhënave të fabrikës

Fshi të gjitha të dhënat e tua personale nga hapësira ruajtëse e brendshme e telefonit, përfshirë informacionin mbi llogarinë e Google, çdo llogari tjetër, cilësimet e sistemit dhe aplikacionit dhe çdo aplikacion të shkarkuar. Rivendosja e telefonit nuk do të fshijë përditësimet e softuerit që ke shkarkuar ose skedarët në kartën microSD, si p.sh. muzikën dhe fotot. Nëse rivendosja e telefonit kryhet në këtë mënyrë, do të të kërkohet të japësh sërish të njëjtin lloj informacioni si gjatë ndezjes së parë të Android.

Nëse nuk arrin të ndezësh telefonin, ka një mënyrë tjetër për të kryer një rivendosje në gjendje fabrike duke përdorur butonat e telefonit. Mbaj shtypur tastin **Volumi lart** dhe shtyp në të njëjtën kohë butonin e **Energjisë** derisa të ndizet ekrani.

# 10.4 Sistemi

## 10.4.1 Data dhe ora

Përdor cilësimet e **Datës dhe orës** për të personalizuar preferencat se si shfaqet data dhe ora.

### Data dhe ora automatike

Përdor **Përdor orën e rrjetit, Përdor orën GPS** ose **Joaktive**.

**Ora automatike e rajonit**

Hap çelësin për të përdorur kohën e zonës orare të siguruar nga rrjeti.

**Vendos datën**

Prek për të hapur një kalendar ku mund të vendosësh manualisht datën e telefonit.

**Vendos orën**

Prek për të hapur një dialog ku mund të vendosësh manualisht orën e telefonit.

**Zgjidh zonën orare**

Zgjidh zonën orare të telefonit nga lista që hapet.

**Përdor formatin 24 orë**

Hap çelësin për të shfaqur kohën duke përdorur format 24 orësh të orës.

**Zgjidh formatin e datës**

Prek për të hapur një dialog ku mund të zgjedhësh formatin e preferuar për shfaqjen e datave.

**Serveri NTP**

Ndrysho serverin NTP në dritaren që hapet kur prek **Serveri NTP**.

### 10.4.2 Ndezja dhe fikja e programuar

Aktivizo çelësat për të aktivizuar ndezjen/fikjen e programuar, si edhe për të vendosur paraprakisht kohën e ndezjes/fikjes dhe kohën e përsëritjes.

### 10.4.3 Qasja

Përdor cilësimet e Qasjes për të konfiguruar çdo shtojcë qasjeje që ke instaluar në telefon.

**TalkBack**

Prek që të aktivizuar/çaktivizuar TalkBack. Me Talkback të aktivizuar, pajisja ofron reagim folës për të ndihmuar përdoruesit e verbër dhe ata me shikim të dobët nëpërmjet përshkrimit çfarë prek, zgjedh dhe aktivizon.



**Ndryshimi i qasjes**

Hap çelësin **Ndryshimi i qasjes** për të kontrolluar telefonin me kombinimet e konfigurueshme të tasteve. Prek **CILËSIMET** majtas lart në ekran për të caktuar kombinimin e tasteve për sjelljet e listuara.

**Pastro masterin** (1)

Hap çelësin për të aktivizuar **Pastro masterin**, që të lejon të vendosësh në fjetje aplikacionet që nuk janë në përdorim për të kursyer baterinë.

**Titrat**

Hap çelësin për të aktivizuar titrat për ekranin e telefonit.

**Lëvizje**

Hap/mbyll çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar funksionin zmadhim/zvogëlim duke prekur tre herë ekranin.

**Tekst i madh**

Hap çelësin për të zmadhuar tekstin e ekranit.

**Tekst me kontrast të lartë**

Hap çelësin për të aktivizuar tekstin me kontrast të lartë.

**Butoni i ndezjes mbyll thirrjen**

Hap çelësin për të lejuar që butoni i **Energjisë** të mbyllë thirrjen.

**Rrotullimi automatik i ekranit**

Me **Rrotullo automatikisht ekranin**, përmbajtja në ekran ose tastierë do të rrotullohet automatikisht kur rrotullon telefonin.

**Thuaji fjalëkalimet**

Hap çelësin për të thënë fjalëkalimet kur i shtyp.

**Shkurtorja e qasjes**

Hap çelësin për të hapur aktivizimin e shpejtë për funksionet e qasjes.

(1) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).

**Konvertimi i tekstit në të folur**

Shko te **Cilësimet > Gjuha dhe hyrja > Konvertimi i tekstit në të folur > Motori i preferuar/Shpejtësia e të folurës/Dëgjo një shembull/Statusi i gjuhës së parazgjedhur** për më shumë.

**Vonesa e prekjes dhe mbajtjes**

Prek që të rregullosh kohëzgjatjen e vonesës së prekjes dhe mbajtjes. Ky funksion mundëson telefonin që të vendosë se sa kohë duhet për të mbajtur prekjen para se të regjistrohet.

**Përkthimi i shpejtë** [(1)]

Aktivizo çelësin për të aktivizuar përkthimin e shpejtë.

**Përmbysja e ngjyrave**

Prek çelësin për të aktivizuar përmbysjen e ngjyrave.

**Korrigjimi i ngjyrave**

Hap çelësin për të aktivizuar korrigjimin e ngjyrave. Mund të zgjedhësh gjithashtu regjimin e korrigjimit në këtë meny.

### 10.4.4 Rregulloret dhe siguria

Hap për të shfaqur informacionin rregullator dhe të sigurisë, duke përfshirë modelin e produktit, emrin e prodhuesit, etj.

### 10.4.5 Opsionet e zhvilluesit

Për të aktivizuar këtë funksion, prek **Cilësimet > Rreth telefonit,** pastaj prek **Numri i ndërtimit** 7 herë. Tani **Opsionet e zhvilluesit** janë të disponueshme. Ekrani i opsioneve të zhvilluesit përmban cilësime që janë të dobishme për zhvillimin e aplikacioneve Android.

(1) Vetëm PIXI 4 (5) (5045X, 5045D).



### 10.4.6 Rreth telefonit

Kjo përmban informacion që varion nga informacioni ligjor, numri i modelit, versioni Android, versioni i bandës bazë versioni Kernel, numri i ndërtimit te ata të listuar më poshtë:

**Përditësimet e sistemit**

Prek që të verifikosh për përditësime sistemi.

**Statusi**

Kjo përmban statusin e baterisë, nivelin e baterisë, statusin e kartës SIM, informacionin e IMEI, adresën IP, etj.

# 11 Përditëso softuerin e telefonit...

Mund të përdorësh mjetin e aktualizimit të celularit ose mjetin e aktualizimit FOTA për të aktualizuar softuerin e telefonit.

## 11.1 Aktualizimi i celularit

Shkarko aktualizimin e celularit nga faqja e internetit të ALCATEL (www. alcatel-mobile.com) dhe instaloje në kompjuter. Aktivizo mjetin dhe përditëso telefonin duke ndjekur hap pas hapi udhëzimet (referoju manualit të përdorimit të ofruar me mjetin). Softueri i celularit tani do të ketë softuerin më të ri.

Të gjitha të dhënat personale do të humbasin përfundimisht në vijim të procesit të përditësimit. Sugjerojmë që para aktualizimit të rezervosh të gjitha të dhënat e tua personale duke përdorur "Smart Suite".

## 11.2 Aktualizimi FOTA

Duke përdorur instrumentin e aktualizimit FOTA (Firmware Over The Air), mund të aktualizosh softuerin e telefonit.

Për të hapur **Përditësimet e sistemit**, shko te **Cilësimet > Rreth telefonit > Përditësimet e sistemit**. Prek skedën Aplikacionet nga ekrani kryesor dhe zgjidh aplikacionin **Përditësimet e sistemit**.

Prek dhe telefoni do të kërkojë softuerin më të fundit. Nëse do të përditësosh sistemin, prek **SHKARKO** dhe kur kjo të ketë mbaruar, prek **INSTALO** për të përfunduar aktualizimin. Tani telefoni do të ketë versionin më të fundit të softuerit.

Duhet të aktivizosh lidhjen e të dhënave përpara se të kërkosh për përditësime. Cilësimet e kontrollit automatik janë të disponueshme edhe kur prek dhe më pas **Cilësimet**.

Nëse ke zgjedhur kontrollin automatik, kur sistemi zbulon një version të ri, ikona do të shfaqet në shiritin e statusit. Prek njoftimin për të hapur direkt **Përditësimet e sistemit**.

Mos e ndrysho vendin e parazgjedhur të ruajtjes gjatë kohës që FOTA shkarkon ose përditëson, për të shmangur gabimet në lokalizimin e paketave të duhura të aktualizimit.



# 12 Aksesorët .................................

Gjenerata e fundit e celularëve ALCATEL ofron një funksion të integruar që lejon përdorimin e telefonit nga distanca, të vendosur p.sh. në një tryezë. Për ata që preferojnë t'i mbajnë bisedat e tyre sekrete, disponohen kufjet.

1 Karikuesi

2 Kabllo USB

3 Kufje

4 Udhëzues i shpejtë i përdorimit

5 Informacioni i sigurisë dhe garancisë

6 Ngjitësja LCD

Përdor vetëm bateritë, karikuesit dhe aksesorët ALCATEL të përfshirë me pajisjen.

# 13 Garanci ..............................................

Telefoni juaj është i garantuar ndaj çdo defekti apo mosfunksionimi që mund të ndodhin në kushtet e përdorimit normal gjatë periudhës së garancisë prej dymbëdhjetë (12) muajsh [1] nga data e blerjes siç tregohet në faturën tuaj origjinale.

Bateritë [2] dhe aksesorët shitur me telefonin tuaj janë gjithashtu të garantuara ndaj çdo defekti që mund të ndodhë gjatë gjashtë (6) muajve të parë [1] nga data e blerjes siç tregohet në faturën tuaj origjinale.

Në rast të ndonjë defekti të telefonit tuaj që ju pengon nga përdorimi normal i tij, ju duhet të informoni menjëherë shitësin tuaj dhe të paraqitni telefonin tuaj me provën tuaj të blerjes.

Nëse defekti konfirmohet, telefoni juaj ose pjesë prej tij ose do të zëvendësohen ose do të rregullohen, siç duhet. Telefoni i riparuar dhe aksesorët kanë të drejtë një (1) muaj garanci për të njëjtin defekt. Riparimi ose zëvendësimi mund të kryhet duke përdorur komponentë të rinovuara nëpërmjet aparatesh që ofrojnë funksionalitet të njëjtë.

Kjo garanci mbulon koston e pjesëve dhe punëve por përjashton çdo kosto tjetër.

Kjo garanci nuk do të aplikohet për defekte të telefonit tuaj dhe\ose aksesorë ve për shkak të (pa ndonjë limitim):

1) Mos përputhje me udhëzimet për përdorimin apo instalimin, ose me standardet teknike dhe të sigurisë të aplikueshme në zonën gjeografike ku telefoni juaj është përdorur,

2) Lidhja për çdo pajisje jo të dhënë ose jo të rekomanduar nga TCL Communication Ltd,

(1) Periudha e garancisë mund të ndryshojë në varësi të shtetit.

(2) Jeta e një baterie të rikarikueshme të telefonisë celulare në drejtim të kohës së bisedës, kohës së gatishmërisë dhe jetës totale të shërbimit, do të varet nga kushtet e përdorimit dhe konfigurimit të rrjetit. Bateritë duke u konsideruar pajisje të shpenzueshme statusi i specifikimeve që ju duhet për të marrë performancën optimale për telefonin tuaj gjatë gjashtë muajve të parë pas blerjes dhe rreth 200 ose më shumë rikarikimeve.



3) Modifikimi ose riparimi i kryer nga individë të pa autorizuar nga TCL Communication Ltd.ose degë të tij ose shitësi juaj,

4) Modifikim, përshtatje ose ndryshim të programit ose pjesës fizike kryer nga individë të pa autorizuar nga TCL Communication Ltd,

5) Moti me shi, rrufe, zjarri, lagështia, infiltrimi i lëngjeve ose ushqimeve, produkte kimike, shkarkimi i dosjeve, përplasje, tension i lartë, korrozioni, oksidimi ...

Telefoni juaj nuk do të riparohet në rast se etiketat apo numrat serik (IMEI) janë hequr ose ndryshuar.

Nuk ka garanci të shprehura, me shkrim, verbale apo të nënkuptuara, përveç kësaj garancie të kufizuar ose garanci të detyrueshme dhënë nga vendi apo juridiksioni juaj.

Në asnjë rast TCL Communication Ltd apo ndonjë nga filialet e saj do të jetë përgjegjëse për dëmet indirekte, të rastësishme ose rrjedhimore të çfarëdo natyre, duke përfshirë por jo kufizuar humbje komerciale apo financiare ose dëmtim, humbje të të dhënave apo humbjen e imazhit në masën e plotë ato dëmtime mund të hidhen poshtë me ligj.

Disa vende/shtete nuk lejojnë përjashtimin ose kufizimin e dëmeve indirekte, të rastësishme ose rrjedhimore, ose kufizimet në kohëzgjatjen e garancive të nënkuptuara, kështu që kufizimet ose përjashtimet nuk mund të zbatohen për ju.

# 14 Zgjidhja e problemeve...............

Para se të kontaktoni qendrën e shërbimit, ju këshilloheni të ndiqni instruksionet më poshtë:

- Ju këshilloheni të karikoni plotësisht baterinë për funksionim optimal.
- Shmangni ruajtjen e sasive të mëdha të të dhënave në telefonin tuaj pasi kjo mund të ndikojë në performancën e tij.
- Përdor mjetet e përditësimit FOTA për të përditësuar programet e telefonit tuaj. Për të pasur qasje te **Përditësimet e sistemit**, prek skedën Aplikacioni nga Ekrani bazë, më pas zgjidh **Përditësimet e sistemit** ose prek **Cilësimet\Rreth telefonit\Përditësimet e sistemit**.

  Prek dhe telefoni do të kërkojë softuerin më të fundit. Nëse dëshiron të përditësosh sistemin, prek butonin dhe kur kjo të përfundojë, prek për të përfunduar përditësimin. Tani telefoni ka versionin më të fundit të softuerit. Duhet të aktivizosh lidhjen e të dhënave ose Wi-Fi përpara se të kërkosh për përditësime. Disponohen edhe cilësimet për kontrollin automatik. Nëse ke zgjedhur kontrollin automati9k, kur sistemi të zbulojë versionin e ri, do të shfaqet një dialog për të zgjedhur për ta shkarkuar ose për ta shpërfillur, njoftimi do të shfaqet edhe në shiritin e statusit. Mos e ndrysho vendin e parazgjedhur të ruajtjes gjatë kohës që FOTA shkarkon ose përditëson, për të shmangur gabimet në lokalizimin e paketave të duhura të përditësimit.
- Përdorni **Rivendos të Dhënat e Fabrikës** dhe mjetin Përmirësim Celulari për të kryer një formatim telefoni ose përmirësim programi (për të rivendosur të dhënat e fabrikës, mbani shtypur tastin **Fuqi** dhe tastin **Volum lart** në të njëjtën kohë nën regjimin fik). TË GJITHA të dhënat e telefonit të përdoruesit: kontaktet, fotot, mesazhet dhe fotografi, aplikacionet e shkarkuara do të humbin përgjithmonë. Këshillohet rreptësisht të ruhen plotësisht të dhënat e telefonit dhe profilit nëpërmjet Smart Suite para bërjes së formatimit dhe përmirësimit.



- Ju lutemi, kini vëmendjen se pasi është kryer rikthimi në gjendje Fabrike i të dhënave, mund t'ju kërkohet të fusni kredencialet e llogarisë Google* që janë përdorur në këtë pajisje para rikthimit në gjendje Fabrike. Përndryshe ju nuk do të jeni në gjendje të përdorni pajisjen. Nëse nuk mbani mend kredencialet e llogarisë tuaj Google, ju lutemi plotësoni procedurën e rigjenerimit të llogarisë Google. Në rast se nuk ja dilni me të - ju lutemi aplikoni te qendra e e autorizuar e riparimit, por mbani mend se nuk do të konsiderohet si çështje garancie.

* E aplikueshme për versionet Android OS duke filluar nga 5.1.

**dhe ndërmerrni kontrollet vijuese:**

**Telefoni im s'mund të ndizet ose ka ngrirë**

- Kur telefoni nuk mund të ndizet, ngarkohet për të paktën 20 minuta për të siguruar fuqinë minimale të baterisë e nevojshme, pastaj të përpiqet për tu ndezur përsëri.
- Kur telefoni kalon në një cikël të mbyllur gjatë animimit të ndezjes-fikjes dhe ndërfaqja e përdoruesit nuk mund të arrihet, shtyp dhe mbaj shtypur butonin e **Energjisë** për ta rivendosur. Kjo eliminon çdo çështje të fikjes së parregullt të SO shkaktuar nga palët e 3-ta APKs.
- Nëse asnjë metodë nuk është efektive, ju lutem rifikni telefonin duke përdorur tastin **Fuqi** dhe tastin **Volum lart** (duke i mbajtur të dy bashkë) ose përmirësoni programin nëpërmjet mjetit Përmirësim celulari.

**Telefoni in nuk është përgjigjur për disa minuta**

- Rindizni telefonin tuaj duke shtypur dhe mbajtur tastin **Fuqi**.
- Hiqni baterinë dhe rifuteni atë, pastaj rindizni telefonin.
- Nëse ende nuk punon, përdor Rivendosjen në gjendje fabrike të të dhënave për të rivendosur telefonin ose Përditësimin e telefonit me versionin e përditësuar të softuerit.

**Telefoni im fiket vetë**

- Kontrolloni që ekrani juaj është i bllokuar kur ju nuk po përdorni telefonin tuaj dhe sigurohuni që tasti **Fuqi** nuk është prekur aksidentalisht ndërkohë që ekrani është i pa bllokuar.
- Kontrolloni nivelin e karikimit të baterisë.
- Nëse nuk punon ende, ju lutem përdorni rivendos të dhënat e Fabrikës për të rikthyer telefonin ose FOTA\Përmirësim Celulari për të përmirësuar programin.

**Telefoni im s'karikohet si duhet**

- Sigurohuni që po përdorni një bateri ALCATEL dhe karikues nga kutia.
- Sigurohuni që bateria është futur si duhet dhe fshini kontaktin e baterisë nëse është pis. Duhet të futet para se ta vendosni karikuesin.
- Sigurohuni që bateria nuk është plotësisht e shkarkuar, nëse fuqia e baterisë është bosh për një kohë të gjatë, duhen rreth 20 minuta të shfaqet indikatori i karikimit të baterisë në ekran.
- Sigurohuni që karikuesi mbahet në kushte normale (0°C në +40°C).
- Kur jeni jashtë, kontrolloni voltazhin hyrës është i pajtueshëm.

**Telefoni im s'mund të lidhet me një rrjet ose "S'ka shërbim" shfaqet**

- Përpiquni të lidheni në një tjetër vendndodhje.
- Verifikoni mbulimin e rrjetit me operatorin tuaj.
- Kontrolloni me operatorin tuaj që karta juaj SIM është e vlefshme.
- Përpiquni të zgjidhni rrjetin(et) e disponueshme manualisht
- Përpiquni të lidheni në një kohë më vonë nëse rrjeti është i mbingarkuar.

**Telefoni im s'mund të lidhet në Internet**

- Kontrolloni që numri IMEI (shtypni *#06#) është i njëjtë me të printuarin në fletën tuaj të garancisë ose kutinë.
- Sigurohuni që shërbimi i hyrjes në internet i kartës tuaj SIM është i disponueshëm.
- Kontrolloni cilësimet e lidhjes në Internet të telefonit tuaj.
- Sigurohuni që jeni në një vend me mbulim rrjeti.
- Përpiquni të lidheni në një kohë të mëvonshme ose në një vend tjetër.

**Kartë e pavlefshme SIM**

- Sigurohuni se karte SIM është futur korrektësisht (shihni "Futja ose heqja e kartës SIM").
- Sigurohuni që çipi në kartën tuaj SIM nuk është dëmtuar ose gërvishtur.
- Sigurohuni që shërbimi i kartës tuaj SIM është i disponueshëm.

**E kam të pamundur të bëj telefonata**

- Sigurohuni që keni formuar një numër të vlefshëm dhe që keni prekur **Thirrje.**
- Për thirrje ndërkombëtare, kontrolloni shtetin dhe kodin e shtetit.



- Sigurohuni që telefoni juaj është i lidhur në një rrjet dhe që rrjeti nuk është i mbingarkuar ose i pa disponueshëm.
- Kontrolloni statusin e abonimin tuaj  me operatorin tuaj (kredite, kartë SIM e vlefshme, etj.).
- Sigurohuni që nuk keni bllokuar thirrjet dalëse.
- Sigurohuni që telefoni juaj nuk është në Regjim fluturimi.

**E kam të pamundur të marrë telefonata**

- Sigurohuni që telefoni juaj është ndezur dhe lidhur në një rrjet (kontrolloni për rrjet të mbingarkuar ose të pa disponueshëm).
- Kontrolloni statusin e abonimin tuaj  me operatorin tuaj (kredite, kartë SIM e vlefshme, etj.).
- Sigurohuni që nuk keni pasuar thirrjet hyrëse.
- Sigurohuni që nuk keni bllokuar thirrjet të caktuara.
- Sigurohuni që telefoni juaj nuk është në Regjim fluturimi.

**Emri i marrësit/numri nuk shfaqen kur një thirrje është marrë**

- Sigurohuni që jeni abonuar në këtë shërbim me operatorin tuaj.
- Telefonuesi juaj ka fshehur emrin e tij/të saj ose numrin.

**Unë s'mund t'i gjej kontaktet e mi**

- Sigurohuni që karta juaj SIM nuk është thyer.
- Sigurohuni që karta juaj SIM është futur si duhet.
- Importoni të gjithë kontaktet e ruajtur në kartën tuaj SIM në telefon.

**Kualiteti i tonit të telefonatave është i dobët**

- Ju mund të rregulloni volumin gjatë një telefonate duke shtypur tastin **Volum lart/Poshtë.**
- Kontrolloni fuqinë e operatorit.

**Unë nuk mundem të përdor veçoritë e përshkruara në manual**

- Kontrolloni me operatorin tuaj për tu siguruar që abonimi juaj e përfshin këtë shërbim.
- Sigurohuni që kjo veçori nuk kërkon një aksesor ALCATEL.

**Kur zgjedh një numër nga kontaktet e mia, numri s'mund të formohet**

- Sigurohuni që ju keni regjistruar korrektësisht numrin në skedarin tuaj
- Sigurohuni që keni zgjedhur prefiksin e shtetit kur telefononi një shtet të huaj.

**Nuk mundem të shtoj një kontakt në kontaktet e mia**

- Sigurohuni që kontaktet e kartës tuaj SIM nuk janë plot; fshini disa skedarë ose ruani skedarët në kontaktet e telefonit (dmth numeratorët profesional ose personal).

**Telefonuesit e mi nuk munden të lënë mesazhe në postën time zanore**

- Kontaktoni me operatorin e rrjetit tuaj për të kontrolluar disponueshmërinë e shërbimit.

**S'mund të hap postën time zanore**

- Sigurohuni që numri i operatorit tuaj të postës zanore është futur saktë në "Numër poste zanore".
- Përpiquni më vonë nëse operatori është i zënë.

**Nuk mundem të dërgoj dhe marr MMS.**

- Kontrolloni disponueshmërine e kujtesës së telefonit se ka mundësi të jetë plot.
- Kontaktoni me operatorin e rrjetit tuaj për të kontrolluar disponueshmërinë e shërbimit dhe kontrolloni parametrat MMS.
- Verifikoni numrin e qendrës së serverit ose profilin tuaj MMS me operatorin tuaj.
- Qendra e serverit mund të jetë fundosur, përpiquni më vonë.

**PIN i kartës SIM i bllokuar**

- Kontaktoni operatorin e rrjetit tuaj për të siguruar kodin PUK (Çelës Personal Zhbllokimi).

**Nuk mundem të lidh telefonin tim me kompjuterin tim**

- Instalo Suitë Inteligjente.
- Kontrolloni që driver i USB tuaj është instaluar si duhet.
- Hap panelin Njoftim për të kontrolluar nëse Smart Suite Inteligjente ka qenë aktivizuar.
- Kontrolloni që keni shënjuar kutinë e verifikimit të rregullimit të USB.
- Kontrolloni që kompjuteri juaj plotëson kërkesat për Instalim Suitë Inteligjente.
- Sigurohuni që po përdorni kabllon e saktë nga kutia.

**Nuk mundem të shkarkoj skedarë të rinj**

- Sigurohuni që ka mjaftueshëm kujtesë telefoni për shkarkimin tuaj.
- Zgjidhni kartën mikroSD si vendin për të ruajtur skedarët e shkarkuar.



- Kontrolloni statusin e abonimit tuaj me operatorin tuaj.

**Telefoni s'mund të zbulohet nga të tjerë nëpërmjet Bluetooth**

- Sigurohuni që Bluetooth është aktivizuar në telefonin tuaj dhe telefoni juaj është i dukshëm nga të tjerë përdorues.
- Sigurohuni që të dy telefonat janë brenda rrezes së zbulimit Bluetooth.

**Si të bëni baterinë tuaj të zgjasë më gjatë**

- Sigurohuni të zbatoni kohë të plotë karikimi (minimumi 2.5 orë).
- Pas një karikimi pjesor, indikatori i nivelit të baterisë mund të mos jetë ekzakt. Pritni për të paktën 20 minuta pas heqjes së karikuesit për të siguruar një tregues ekzakt.
- Rregulloni shkëlqimin e ekranit si duhet.
- Zgjasni intervalin e kontrollit automatik të postës elektronike aq gjatë sa të mundeni.
- Përditësoni lajmet dhe informacionin e motit në kërkesë manuale ose rrisni intervalin e tyre të kontrollit automatik.
- Dilni nga aplikacione që ekzekutohen në sfond në se ato nuk po përdoren për një kohë të gjatë.
- Çaktivizoni Bluetooth, Wi-Fi ose GPS kur nuk janë në përdorim.

**Telefoni do të ngrohet kur ndiqet nga telefonata të zgjatura, luajtje lojërash, lundrim në internet ose ekzekutim i aplikacioneve të tjera komplekse.**

- Kjo ngrohje është pasojë normale e trajtimit të tepruar të të dhënave CPU. Përfundimi i veprimeve të mësipërme do të bëjë telefonin tuaj të kthehet në temperatura normale.

**Pasi është kryer rikthim në gjendje Fabrike, pajisja ime kërkon të fus kredencialet e llogarisë Google dhe unë nuk mund ta përdor atë duke evituar këtë veprim*.**

- Pasi është kryer rikthimi në gjendje Fabrike, ju duhet të fusni kredencialet e llogarisë origjinale Google* që janë përdorur në këtë pajisje para rikthimit në gjendje Fabrike të të dhënave. Përndryshe ju nuk do të jeni në gjendje të përdorni pajisjen. Nëse nuk mbani mend kredencialet e llogarisë tuaj Google, ju lutemi plotësoni procedurën e rigjenerimit të llogarisë Google. Në rast se nuk ja dilni me të - ju lutemi aplikoni te qendra e e autorizuar e riparimit, por mbani mend se nuk do të konsiderohet si çështje garancie.

* E aplikueshme për versionet Android OS duke filluar nga 5.1.

**Nuk dëgjoj kur dikush më telefonon/njoftimet e mesazheve në ekran.**

- Ju lutemi kontrolloni nëse regjimi Ndërprerjet/Mos shqetësoni është aktivizuar në pajisjen tuaj. Nëse është aktivizuar ju mund të shihni një simbol "Yll" (për versionin Android OS 5.X) ose ikonën (për versionin Android OS 6.X) shfaqur te paneli i njoftimeve. Në këtë rast ju duhet të çaktivizoni regjimin Ndërprerjet/Mos shqetësoni. Për ta bërë atë, thjesht shtypni tastin volum lart ose poshtë dhe zgjidhni "Të gjithë" (te Android 5.X) ose modifikojeni atë te Cilësimet → Tinguj dhe njoftime → Ndërprerjet ( për Android 5.X) ose Mos shqetësoni ( për Android 6.X).

**Pajisja ime më kërkon që të fus një fjalëkalim/kod/çelës që nuk e mbaj mend ose nuk e di për shkak se kjo pajisje ka qenë përdorur nga një person tjetër më parë dhe unë nuk mund ta marr këtë fjalëkalim/kod/çelës nga ai/ajo.**

- Kërkesa e fjalëkalimit/kodit/çelësit mund të jetë shkaktuar nga i njëjti funksion i sigurisë së aktivizuar në këtë pajisje. Ju mund të provoni të kryeni një rikthim në gjendje Fabrike të të dhënave, por mbani mend se nëse kjo nuk ju ndihmon, nevojitet të aplikoni te një qendër e autorizuar riparimi dhe nuk do të konsiderohet si çështje garancie.



# 15 Specifikime..............................

PIXI 4 (4) (4034X, 4034D, 4034F)

| | |
|---|---|
| **Procesori** | MT6580M+1.3GHz Quad core |
| **Platforma** | Android™ M |
| **Memoria** | 4GB ROM + 512MB RAM (1)<br>8GB ROM + 1GB RAM (2) |
| **Dimensionet (LxGjxTh)** | 121,3 X 64,4 X 9,7 mm |
| **Pesha** | Rreth 110 g me bateri |
| **Ekrani** | Ekran me prekje 4,0 inç me rezolucion 800×480 WVGA |
| **Rrjeti** | GSM: 850/900/1800/1900<br>UMTS: 900/2100<br>(Frekuenca e brezit dhe shpejtësia e të dhënave varet nga operatori.) |
| **GPS** | Antenë ndihmëse GPS/GPS i brendshëm |
| **Lidhshmëria** | • Bluetooth V4.0/A2DP<br>• Wi-Fi IEEE 802.11 b/g/n<br>• Fole audio 3,5 mm<br>• Micro-USB |
| **Kamera** | • Kamerë e pasme 3MP FF dhe kamerë e përparme 1,3MP (1)<br>• Kamerë e pasme 8MP FF dhe kamerë e përparme 5MP FF (2) |

| | |
|---|---|
| **Formatet audio të mbështetura** | AMR, AWB, MP2. MP3. OGG VORBIS. WAV(ADPCM/Alaw/Ulaw/Raw). APE, FLAC |
| **Formatet video të mbështetura** | H.263, H.264 AVC, MPEG-4 SP, VP8 |
| **Bateri** | • Bateri e rikarikueshme litium-jon<br>• Kapaciteti: 1500 mAh |
| **Fole zgjerimi** | karta e kujtesës microSD™ (disponueshmëria e kartës microSD varet nga tregu) |
| **Veçoritë speciale** | • G-sensor |

**Shënim:** Specifikimet u nënshtrohen ndryshimeve pa njoftim paraprak.

PIXI 4 (5) (5045X, 5045D)

| | |
|---|---|
| **Procesori** | MTK6735M+1.0GHz Quad core |
| **Platforma** | Android™ M |
| **Memoria** | 8GB ROM + 1GB RAM |
| **Dimensionet (LxGjxTh)** | 140,7 X 72,5 X 9,5 mm |
| **Pesha** | Rreth 169g me bateri |
| **Ekrani** | Ekran me prekje 5,0 inç me rezolucion 854×480 FWVGA |
| **Rrjeti** | GSM: 850/900/1800/1900<br>UMTS: 850/900/1900/2100<br>LTE: B1/3/7/8/20/28A<br>(Frekuenca e brezit dhe shpejtësia e të dhënave varet nga operatori.) |

(1) Vetëm 4034X, 4034D.
(2) Vetëm 4034F.



| | |
|---|---|
| **GPS** | Antenë ndihmëse GPS/GPS i brendshëm |
| **Lidhshmëria** | • Bluetooth V4.0/A2DP<br>• Wi-Fi IEEE 802.11 b/g/n<br>• Fole audio 3,5 mm<br>• Micro-USB |
| **Kamera** | • Kamerë e pasme 8MP FF dhe kamerë e përparme 5MP FF |
| **Formatet audio të mbështetura** | WAV, MP3, MP2, AAC, AMR, MIDI, Vorbis, APE, AAC+, FLAC |
| **Formatet video të mbështetura** | H.263, H.264 AVC, MPEG-4 SP, VP8 |
| **Bateri** | • Bateri e rikarikueshme litium-jon<br>• Kapaciteti: 2000 mAh |
| **Fole zgjerimi** | karta e kujtesës microSD™ (disponueshmëria e kartës microSD varet nga tregu) |
| **Veçoritë speciale** | • G-sensor<br>• Afërsia |

**Shënim:** Specifikimet u nënshtrohen ndryshimeve pa njoftim paraprak

PIXI 4 (5) (5010X, 5010D, 5010U)

| | |
|---|---|
| **Procesori** | MT6580M+1.3GHz Quad core |
| **Platforma** | Android™ M |
| **Memoria** | 8GB ROM + 1GB RAM |
| **Dimensionet (LxGjxTh)** | 140,7 X 72,7 X 9,5 mm |
| **Pesha** | Rreth 148g me bateri |

| | |
|---|---|
| **Ekrani** | Ekran me prekje 5,0 inç me rezolucion 854×480 FWVGA |
| **Rrjeti** | 850/900/1800/1900<br>UMTS: 900/2100<br>(Frekuenca e brezit dhe shpejtësia e të dhënave varet nga operatori.) |
| **GPS** | Antenë ndihmëse GPS/GPS i brendshëm |
| **Lidhshmëria** | • Bluetooth V4.0/A2DP<br>• Wi-Fi IEEE 802.11 b/g/n<br>• Fole audio 3,5 mm<br>• Micro-USB |
| **Kamera** | • Kamerë e pasme 8MP FF dhe kamerë e përparme 5MP FF |
| **Formatet audio të mbështetura** | WAV, MP3, MP2, AMR, MIDI, Vorbis, APE, AAC, AAC+, FLAC |
| **Formatet video të mbështetura** | H.263, H.264 AVC, MPEG-4 SP, VP8 |
| **Bateri** | • Bateri e rikarikueshme litium-jon<br>• Kapaciteti: 2000mAh |
| **Fole zgjerimi** | microSD™ memory card<br>karta e kujtesës microSD™ (disponueshmëria e kartës microSD varet nga tregu) |
| **Veçoritë speciale** | • G-sensor |

**Shënim:** Specifikimet u nënshtrohen ndryshimeve pa njoftim paraprak



ALCATEL është markë tregtare e Alcatel-Lucent
dhe përdoret nën liçencë nga
TCL Communication Ltd.

© Të drejtat e autorit 2016 TCL Communication Ltd
Të gjithë të drejtat e rezervuara

TCL Communication Ltd rezervon
të drejtën për të ndryshuar materialin
ose specifikimet teknike
pa njoftim paraprak,

Të gjitha zilet "Nënshkrim" mishëruar në këtë telefon janë kompozuar, rregulluar dhe miksuar nga NU TROPIC (Amar Kabouche).

Shqip - CJA28S0ALBTA